

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6169  
E enjte, 19 nëntor 2020  
çmimi 0.40

## UÇK-ja ishte themeluar për çlirimin e Kosovës

FAQE 5



Shkruan: Ramiz LLADROVCI

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË MËRKURËN ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA STATUSORE APO E ECURISË SË ÇËSHTJES PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, JAKUP KRASNËQIT DHE REXHEP SELIMIT

## MBROJTJA E ISH-UDHËHEQËSVE TË UÇK-së KËRKON NISJEN E GJYKIMIT PAS 18 MUAJSH

Në konferencën statusore në Hagë, avokatët mbrojtës të ish-krerëve të UÇK-së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kanë kërkuar që gjykimi ndaj klientëve të tyre të mos nisë përpara verës së vitit 2022. Avokati mbrojtës i Thaçit, David Hooper dhe ai i Veselit, Ben Emmerson, kanë thënë se u duhen të paktën 18 muaj që të kryejnë hetime, në mënyrë që të përgatisin mbrojtjen. Ndërkaq Hooper e ka quajtur "absurd" pretendimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar që gjykimi të nisë në qershorin e vitit të ardhshëm. Gjatë kësaj seance, mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka paralajmëruar se do të kërkojnë lirim me kusht për klientët e tyre. Në fund të konferencës statusore, gjykatësi ka njoftuar se seanca e radhës do të mbahet në mesin e muajit dhjetor



### AKTUALE



**"PFIZER" PËRFUNDON TESTIMIN E VAKSINËS, 95 PËR QIND EFEKTIVE KUNDËR COVID-19** F.2

**NË KOSOVË EDHE 11 TË VDEKUR DHE 720 RASTE TË REJA ME COVID-19** F.6

**OSMANI: PJESËMARRJA E GRAVE NE PROCESIN E DIALOGUT, VENDIM I NEVOJSHËM DHE I MENÇUR** F.7

**PËRURORHET OBJEKTI I RI I URGJENCËS NË MALISHEVË** F.7

### EKONOMI

**GËRXXHALIU: INVOLVIMI I 'GUARDIA DI FINANZA', SHPRESË PËR ZBULIMIN E KRIMIT FINANCIAR** F.9

**PAS DY VITESH HETIMESH, HIQET NDALESA E FLUTURIMIT PËR BOEING 737 MAX** F.8

### SPORT



**KOSOVA MPOSHTI MOLDAVINË, MBETET NË LIGËN C** F.14



## KMDLNJ KËRKON QË TË REDUKTOHEN SEANCAT E KUVENDIT

FAQE 3

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka kërkuar që, në përputhje me situatën dhe për shkak të rrezikut të madh me pandeminë Covid-19,

seancat e Kuvendit të reduktohen, pasi sipas KMDLNJ-së seancat e stërzgatura të Kuvendit janë duke e rrezikuar shëndetin. "KMDLNJ rekomandon që seancat të mbahen

vetëm për gjëra të domosdoshme, të diskutohet qartë dhe shkurt dhe të merren vendime që janë të domosdoshme", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhëp isht Tetov\*  
Gur°z-Perizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk) Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
ND, RTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOV.  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin", Kosov\*,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## “Pfizer” përfundon testimin e vaksinës, 95 për qind efektive kundër Covid-19

NJU JORK, 18 NËNTOR- Një analizë përfundimtare e fazës së tretë të vaksinës ndaj koronavirusit nga kompania “Pfizer” tregon se ajo ishte 95 për qind efektive në parandalimin e infeksionit, madje edhe tek të moshuarit. Vaksina nuk shkaktoi efekte anësore të mëdha, ka njoftuar kompania të mërkurën.

Të dhënat konfirmojnë pretendimin fillestar të “Pfizer”-it për një efikasitet më të mirë se 90 për qind të

vaksinës. “Efikasiteti ishte i qëndrueshëm midis moshës, racës dhe etnisë demografike. Efikasiteti i vërejtur tek të moshuarit mbi 65 vjeç ishte mbi 94 për qind”, ka njoftuar “Pfizer” dhe partneri i saj gjerman “BioNTech” në një deklaratë të përbashkët. Kompania “Pfizer” ka njoftuar se do të aplikojë për autorizimin urgjent në ShBA brenda disa ditëve. Analiza përfundimtare vjen vetëm një javë pasi rezultatet fillestare

treguan se vaksina ishte më shumë se 90 për qind efektive. Edhe kompania “Moderna.Inc” ka lëshuar të hënën të dhënat paraprake për vaksinën e saj, duke treguar efektivitet të ngjashëm. Provat e suksesshme të dy vaksinave kundër koronavirusit kanë rritur shpresat për t'i dhënë fund pandemisë që ka vrarë më shumë se 1.3 milionë njerëz në të gjithë botën dhe ka shkaktuar kërdi në ekonomi dhe jetën e përditshme.



## Mijëra gjermanë protestojnë kundër planeve për masa ndaj pandemisë

BERLIN, 18 NËNTOR- Mijëra qytetarë u mblodhën të mërkurën në Berlin për të protestuar kundër planeve të kancelares, Angela Merkel, që të fitojë më shumë kompetenca për të zbatuar kufizimet që synojnë frenimin e përhapjes së koronavirusit. Policia gjermane përdori topa uji në përpjekje për të shpërndarë protestuesit dhe arrestoi disa prej tyre. Protestuesit hodhën shishe dhe gjësende tjera ndaj policisë. Parlamenti i Gjermanisë pritet të miratojnë ligje që mund të lejojë qeverinë të vendosë kufizime siç është distanca fizike; mbajtja e maskave;

konsumimi i alkoolit në publik, mbyllja e dyqaneve dhe ndalimin e ngjarjeve sportive. Këto kompetenca u takojnë lendeve gjermane. Megjithëse shumica e gjermanëve pranojnë “masat e fundit të izolimit” për të trajtuar një valë të dytë të koronavirusit, kritikët thonë se ligji i jep qeverisë shumë fuqi dhe rrezikon të drejtat civile të qytetarëve pa miratimin e parlamentit. Alternativa për Gjermaninë (AfD) e ekstremit të djathtë madje e ka krahasuar atë me Aktin e vitit 1933 që hapi rrugën e diktaturës naziste të Hitlerit.



Protestuesit nuk kishin veshur maska dhe as nuk mbanin distancën fizike.

Oficerët e policisë u rreshtuan për të ndaluar demonstruesit të afroreshin shumë pranë

ndërtesës së parlamentit. Gjermania, ekonomia më e madhe e Evropës, u vlerësua pozitivisht për mbajtjen e niveleve të infeksionit dhe vdekjeve, nën ato të shumë fqinjëve të saj në fazën e parë të krizës, por tani është në mes të një vale të dytë, si shumica e pjesës tjetër të Evropës. Instituti Robert Koch të mërkurën tha se janë konfirmuar edhe 17,561 raste të reja me koronavirusin e ri, që e shkaktonte sëmundjen Covid-19. Numri i përgjithshëm i të infektuarve ka arritur në 833,307 ndërsa numri i të vdekurve është 13.119, raporton Reuters.

## ShBA-ja redukton prezencën ushtarake në Irak dhe Afganistan



WASHINGTON, 18 NËNTOR- Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do të reduktojnë për 2.500 numrin e trupave të saj në Afganistan dhe Irak, ka konfirmuar Departamenti i Mbrojtjes. Presidenti Donald Trump kishte paralajmëruar më parë se do të shkurtoje prezencën ushtarake amerikane në të dyja vendet. Ky reduktim do të bëhet përpara se Presidenti Trump të largohet nga zyra, ka njoftuar Pentagoni. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens

Stoltenberg, ka paralajmëruar për rrezikun e një “çmimi të lartë” nëse ShBA-ja dhe forcat aleate largohen nga Afganistani në mënyrë të befashme. Në një deklaratë, Stoltenberg ka thënë se Afganistani rrezikon edhe një herë të bëhet një platformë për terroristët ndërkombëtarë që të ndër marrin dhe organizojnë sulme. Numri i trupave në Irak do të shkurtohet nga 500 në 2,500, ndërsa numri i personelit të shërbimit në Afganistan do të

bjerë nga 4,500 në rreth 2,500. Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Mbrojtjes së ShBA-së, Chris Miller tha se ky vendim reflekton politikën e presidentit Trump “për të sjellë luftërat në Afganistan dhe Irak në një përfundim të suksesshëm dhe të përgjegjshëm dhe për të sjellë në shtëpi, shërbyesit tonë të guximshëm”. Liderët ushtarakë ishin njoftuar gjatë fundjavës për planet e tërheqjes, bazuar në zyrtarët e cituar nga Associated Press.

## Edhe nëntë pacientë humbin jetën nga Covidi në Shqipëri

Tiranë, 18 nëntor- Në 24 orët e fundit në Shqipëri kanë rezultuar pozitivë me koronavirus 711 qytetarë, ndërkaq kanë humbur jetën nga ky virus nëntë pacientë. Në 24 orët e fundit janë

shëruar edhe 412 pacientë, duke e çuar numrin e të shëruarve në 14,216 që nga fillimi i kësaj pandemie. Aktualisht në tri Spitalet Covid, po trajtohen 420 pacientë, 15 në terapi

intensive, nga të cilët gjashtë të intubuar. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri u ka bërë thirrje qytetarëve të respektojnë rregullat e higjienës, distancimit fizik dhe

mbajtjen e maskës në çdo ambient jashtë shtëpisë. Kjo ministri ka lutur qytetarët që janë në pritje të përgjigjes së testit, të qëndrojnë të izoluar, duke respektuar detyrimin e vetekarantinimit.



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) thotë se seancat e stërzgjatura të Kuvendit janë duke e rrezikuar shëndetin

## KMDLNj kërkon që të reduktohen seancat e Kuvendit

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar që, në përputhje me situatën dhe për shkak të rrezikut të madh me pandeminë Covid-19, seancat e Kuvendit të reduktohen, pasi sipas KMDLNj-së seancat e stërzgjatura të Kuvendit janë duke e rrezikuar shëndetin. “KMDLNj rekomandon që seancat të mbahen vetëm për gjëra të domosdoshme, të diskutohet qartë dhe shkurt dhe të merren vendime që janë të domosdoshme”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 18 NËNTOR-** Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) që në fillim të pandemisë Covid-19, me një letër drejtuar Kryesisë së Kuvendit dhe kryetares Vjosa Osmani, pati kërkuar që të ndërmerren masa mbrojtëse për deputetët dhe administratën.

Përkundër kësaj, një numër i deputetëve dhe administratës janë infektuar me Covid-19. Së fundi, edhe kryetarja e Kuvendit dhe ushtruesja e presidentes Vjosa Osmani ka rezultuar pozitiv me Covid.

KMDLNj përmes një reagimi për medie ka theksuar se seancat e stërzgjatura të

Kuvendit po e rrezikojnë shëndetin. “KMDLNj vlerëson se kohëve të fundit seancat e Kuvendit të Kosovës, me shterpësinë e diskutimeve, jo që nuk po prodhojnë efektin e duhur por seriozisht po e rrezikojnë shëndetin e të pranishmëve. Kjo, sidomos është e theksuar gjatë interpelancave ku në sallë janë mbi 70 deputetë dhe të pranishëm dhe ku diskutimet stërzgjeten me orë të tëra, pa e dhënë asnjë rezultat. Çfarë kuptimi ka një seancë që zgjatë 10 orë diskutime, sikur gjatë fushatave elektorale dhe, si përfundim nuk janë në gjendje të miratojnë asnjë rezolutë, marrëveshje apo ligj, madje as të përafrojnë qëndrimet të cilat thellohen edhe më shumë. Shembull eklatant për

këtë janë diskutimet dhe mosvotimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Me mosvotimin e këtij Projektligji, deputetët refuzues të Kuvendit të Kosovës po sillen sikur buxheti i Kosovës është pronar i buxhetit të Bankës Botërore e jo një buxhet social dhe palativ që me mjete tejet simbolike po mundohet t’ua zbusin dhimbjet shumicës së bizneseve, para se ato të falimentojnë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, “seancat me diskutime të zbrazëta, monotone të cilat përfundojnë

kryesisht me disa deputetë që e luajnë rolin e mohikanit të fundit, pa kuorum që, përveç se nuk prodhojnë asgjë, i mërziqin qytetarët para ekranit televiziv sikur që e rrezikojnë shëndetin e tyre dhe të pranishmëve”.

KMDLNj kërkon që, në përputhje me situatën dhe për shkak të rrezikut të madh, Kryesia e Kuvendit, bashkë me grupet parlamentare të ofrojë një zgjidhje që seancat e Kuvendit të reduktohen në përputhje me rrezikun në mënyrë që të ruhet shëndeti i të pranishmëve. “Në kohën kur

pandemia e shkaktuar nga Covid-19 ka përshkallëzuar në tërë botën dhe kur kemi një rrezikshmëri shumë të lartë dhe kur janë ndërmarrë shumë masa kufizuese nuk ka asnjë kuptim mbajtja e këtyre seancave të stërzgjatura. KMDLNj rekomandon që seancat të mbahen vetëm për gjëra të domosdoshme, të diskutohet qartë dhe shkurt dhe të merren vendime që janë të domosdoshme. Me normalizimin e situatës do të normalizohej edhe puna e Kuvendit”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

## Interesim i ulët i qytetarëve për të marrë pjesë në diskutimet publike të komunave

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 18 NËNTOR-** Demokraci për Zhvillim (D4D) ka organizuar të mërkurën konferencën për lansimin e dokumentit “Raport mbi performancën e komunave në fushën e komunikimit me qytetar/e”, ku u prezantuan të gjeturat nga matja e perceptimit të qytetarëve në tërë territorin e Kosovës në muajin qershor të vitit 2020, duke bërë një krahasim me të dhënat e ngjashme të viteve paraprake.

Sipas hulumtimit të realizuar nga D4D, pjesëmarrja e qytetarëve në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse të organizuara nga komuna nuk është shumë e kënaqshme, ku vetëm 11.1 për qind e të anketuarve kanë marrë pjesë një herë apo më shumë në diskutime publike të organizuara nga komuna, 20.1 për qind e tyre nuk kanë marrë



pjesë në këto diskutime publike edhe pse kanë qenë të informuar, derisa rreth 68.7 për qind e tyre nuk kanë marrë pjesë dhe as që kanë qenë të informuar mbi organizimin e këtyre dëgjimeve publike nga komuna në të cilën jetojnë. Prezantimi i këtij raporti u pasua me një diskutim mbi rezultatet e raportit por edhe për gjendjen aktuale të

qeverisjes së mirë në nivel lokal dhe atë qendror, ku të ftuar ishin Bekim Salihu, Instituti GAP, Besnik Muçaj, Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), dhe Visar Rashiti, organizata Demokraci Plus (D+). Në këtë drejtim, të ftuarit në panel theksuan se problemi nuk qëndron vetëm tek komunat, por edhe tek interesimi i ulët i qytetarëve

për të marrë pjesë në diskutime publike, meqë një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk konsiderojnë që kërkesat dhe shqetësimet e tyre merren parasysh nga Komuna gjatë hartimit të politikave lokale. Paneli gjithashtu theksoi rëndësinë e gjetjes së një mënyre nga komunat për nxitje të qytetarëve për pjesëmarrje në proceset

politikëbërëse dhe vendimmarrëse, dhe se çdo takim që realizohet me qytetarë në këto procese të evidentohet.

Si përfundim, përkundër që nga matja e perceptimit të qytetarëve mbi punën e komunave dhe cilësisë së shërbimeve komunale, në përgjithësi ka përmirësim në qeverisjen e nivelit lokal, mirëpo duhet një angazhim më i madh në këtë drejtim si nga Komunitat, ashtu edhe nga qytetarët dhe Shoqëria Civile, për të përmirësuar edhe më shumë gjendjen e shoqërisë kosovare.

Ky aktivitet dhe raport është realizuar në kuadër të projektit “Qeverisje lokale transparente dhe llogaridhënëse”, mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung, zyra në Prishtinë (FES) në kuadër të programit Kosova që Duam, dhe implementuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

TË MËRKURËN ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA STATUSORE APO E ECURISË SË ÇËSHTJES PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA NË HAGË NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, JAKUP KRASNIQIT DHE REXHEP SELIMIT

# MBROJTJA E ISH-UDHËHEQËSVE TË UÇK-së KËRKON NISJEN E GJYKIMIT PAS 18 MUAJSH

Në konferencën statusore në Hagë, avokatët mbrojtës të ish-krerëve të UÇK-së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, kanë kërkuar që gjykimi ndaj klientëve të tyre të mos nisë përpara verës së vitit 2022. Avokati mbrojtës i Thaçit, David Hooper dhe ai i Veselit, Ben Emmerson, kanë thënë se u duhen të paktën 18 muaj që të kryejnë hetime, në mënyrë që të përgatisin mbrojtjen. Ndërkaq Hooper e ka quajtur "absurd" pretendimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar që gjykimi të nisë në qershorin e vitit të ardhshëm. Gjatë kësaj seance, mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka paralajmëruar se do të kërkojnë lirim me kusht për klientët e tyre. Në fund të konferencës statusore, gjykatësi ka njoftuar se seanca e radhës do të mbahet në mesin e muajit dhjetor



**EPOKA ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 NËNTOR- Në konferencën statusore apo të ecurisë së çështjes pranë Dhomave të Specializuara në Hagë, mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, ka kërkuar që gjykimi nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të nisë jo më herët se në verën e vitit 2022. Gjatë kësaj

seance, mbrojtja ka paralajmëruar se do të kërkojnë lirim me kusht për klientët e tyre.

Kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të PDK-së, Kadri Veseli, deputetit dhe ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit është konfirmuar aktakuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të gjithë, aktualisht gjenden në paraburgim në Hagë dhe janë

deklaruar të pafajshëm.

Avokati mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, David Hooper dhe ai i ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri

Veseli, Ben Emmerson, thanë se u duhen të paktën 18 muaj që të kryejnë hetime, në mënyrë që të përgatisin mbrojtjen. Emmerson ka theksuar se mendon se gjykimi mund të

zgasë deri në dy vjet.

Hooper po ashtu e quajti "absurd" pretendimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar që gjykimi të nisë në qershor të vitit 2021.


Ai ka thënë se mbrojtjes i duhet që të ketë qasje në një aktakuzë që ka shkallë më të vogël të redaktimit dhe që materiali duhet të jetë i hapur për mbrojtjen.

Avokatja mbrojtëse e Jakup Krasniqit, Venkateswari Alagendra, dhe ai i Rexhep Selimit, David Young po ashtu thanë se u duhet kohë e mjaftueshme që të mund të kryejnë hetime të thella.

Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka pohuar se në këtë konferencë statusore nuk do të përcaktohet data për nisjen e procesit gjyqësor.

Konferencën statusore, apo konferencën mbi ecurinë e çështjes e thërret gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve midis palëve. Në këtë konferencë, prokuroria tregon çfarë lloji të provave disponon.

Sipas aktakuzës, Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi dyshohen për veprat penale që kanë të bëjnë me krime lufte, ndalim të



Screenshot (Official website)

paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe krime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, zhdukje me forcë të personave dhe përndjekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit, 1999.

Krimet pretendohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë, përkatësisht në Kukës dhe Cahan.

Sipas një parashtrere të Prokurorit të Specializuar dërguar Dhomave të Specializuara për këtë konferencë, e të publikuar në faqen e tyre të internetit, Prokuroria pretendon se për konfirmimin e aktakuzës ka disponuar me material prej rreth 43 mijë faqe, duke përfshirë raporte, deklaratat të dëshmitarëve, fotografi, e mbi 20 orë material audio-vizuel. Prokuroria thotë se mbrojtjes parashikon t'i dorëzojë provat siç janë raportet, fotografitë, dokumentet e UÇK-së, duke përfshirë urdhrat, rregulloret etj. Prokuroria pretendon se lënda e saj disponon me gati 100.000 prova.

Me qëllim të konfirmimit të aktakuzës kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Prokuroria e Specializuar në Hagë është mbështetur te 153 dëshmitarë dhe synon që përsëri të mbështetet në shumicën e tyre gjatë gjyqimit. "Prokuroria aktualisht parashikon shtimin e afërsisht 50 dëshmitarëve të tjerë në listën e dëshmitarëve për gjykimin, megjithëse numri përfundimtar i dëshmitarëve mund të ndryshojë, varësisht nga rezultati të hetimeve të mbetura", thuhet në këtë parashtrere.

Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar brenda 30 ditësh, që nga paraqitja e parë e të akuzuarve në gjykatë, duhet të njoftojë mbrojtjen për çdo material dhe provë që ka në zotërim, si deklaratat, dokumente apo fotografi.

Mbrojtja tha se nxjerrja e materialeve duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, ndërkaq gjykatësi propozoi që Prokurorisë t'i jepet dy javë shtesë që të nisë me dorëzimin e materialeve te pala mbrojtëse. Prokuroria në parashtrere thotë se redaktimi i materialeve është diçka që duhet të bëhet me kujdes, si dhe që përkthimi i materialit mbështetës të aktakuzës në gjuhën shqipe është në proces e sipër.

### Mbrojtja: Nuk ka arsye që të akuzuarit të qëndrojnë në paraburgim

Gjatë konferencës statusore, avokati i Thaçit, David Hooper ka ngritur çështjen e mbajtjes

në paraburgim të klientit të tij, duke thënë se së shpejti, pala mbrojtëse do të aplikojë për lirim me kusht.

Ai ka theksuar se ka pranuar urdhërrrestin e lëshuar ndaj Thaçit, por sipas tij, ajo ka pasur redaktime, prandaj ai kërkoi që t'i dorëzohen argumentet e përdorura në urdhërrrestin ndaj klientit të tij. "Burgimi është përjashtim dhe në kushtet e mungesës së kriterëve, atëherë prezumohet lirimi", është shprehur Hooper. Edhe avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka theksuar se nuk ka arsye që Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi të mbeten në paraburgim, duke shtuar se nuk ekziston rreziku i arratisjes së tyre, por sipas tij, Prokuroria pretendon se të pandehurit kanë bërë "ndërhyrjen në rregullin e drejtësisë". "Prokuroria duhet të tregojë se pse këta katër të akuzuar duhet të qëndrojnë në burg", ka thënë ai.

Duke komentuar aktakuzën, Emmerson ka thënë: "Nuk ka ekzistuar ndërmarrje e përbashkët kriminale ashtu siç përcaktohet në aktakuzë dhe nuk ka baza të tjera ligjore për ta quajtur zotin Veseli përgjegjës për aktet kriminale të të tjerëve".

Avokati Emmerson ka shtuar se UÇK-ja ishte një lëvizje dhe kryengritje popullore spontane, "e organizuar në mënyrë minimale për të mbrojtur popullatë civile nga gjenocidi dhe kriminelët serbë". "Më shumë se 10,000 civilë shqiptarë janë vrarë nga forcat serbe, në masakra të planifikuara dhe vendi u përfshi nga kaosi dhe nga dhuna. Shqiptarët u varrosën në varre masive nga forcat serbe dhe shumë pastaj u zhvarrosën dhe ka shumë të tjerë, që trupat e tyre gjenden në Serbi dhe janë fshehur atje", ka thënë ai.

Sipas Emmersonit, aktakuza e Prokurorisë, mund të ketë edhe prova "false". "Aktakuza e Prokurorisë është ndërtuar me erna, janë bashkuar disa akuzat të ndryshme, nga zona të ndryshme të Kosovës, janë përmendur shumë emra njerëzish dhe njerëz të ndryshëm që pretendojnë se kanë qenë anëtar të UÇK-së kanë sajuar të gjitha këto akuzat dhe janë bashkuar të gjitha to në këtë ndërmarrje të përbashkët kriminale që paraqet Prokuroria. Nga përvoja e mëparshme në Tribunalin për ish-Jugosllavi na ka treguar se mund të ketë prova false që janë paraqitur në shumë raste nga Prokuroria. Ndoshta Prokuroria nuk e ka ditur që ato janë false, megjithatë ne duhet të bëjmë një ekzaminim të provave që paraqet Prokuroria", ka thënë ai. Në fund të konferencës statusore, gjykatësi njoftoi se seanca e radhës do të mbahet në mesin e muajit dhjetor.

# UÇK-ja ISHTE THEMELUAR PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS



Shkruan: **Ramiz LLADROVCI**

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), me të drejtë, në historinë e popullit shqiptar, dëshmoi se ka pararendëse për nga nami dhe frytë e luftës, vetëm ushtrinë e Skënderbeut. Andaj, është shumë herët që historia ta vlerësojë në tërë thellësinë dhe gjerësinë e saj këtë ushtri çlirimtare, por, gjithsesi, ishte, është dhe mbetet ushtri që shkroi dhe vulosi historinë e një pjese të kombit, të një shteti të ri, Republikën e Kosovës. Fillimet e UÇK-së, janë të njohura për të gjithë neve që ishim në qelizat e para të krijimit të UÇK-së, ndërsa veneruesit gjakftohtë dhe ekspertët me dije për shkencat ushtarake, ende mund të habiten që një superfuqi të armëve konvencionale si Serbia, të pësojë humbje katastrofale nga UÇK-ja. Ne duhet t'i përgjigjemi pyetjes së thjeshtë, çka na solli fitoren? Edhe ushtria e Lidhjes së Prizrenit ishte në të drejtën e saj dhe popullin që përfaqësonte, edhe ushtria që ishte pranë Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, ishte e njohur forca e Hasan Prishtinës, Idriz Seferit, Bajram Currit, Isë Boletinit, Azem Bejtës, Mehmet Gradicës dhe Shaban Polluzhës. Është fakt i ditur se asnjëra nga këto ushtri, nuk arriti as ta çlironte, as ta mbronte Kosovën, as të na linte trashëgim lirinë nga okupatori otoman, Mbretëria Serbe-Kroate e Sllovene dhe Jugosllavia komuniste.

Nga Skënderbeu e këndej, të gjithë ishin në të drejtën historike për liri, por nuk e arritën, përkundër sakrificës, terrorit dhe gjenocidit kundër popullit tonë. Këtu fillon historia. Lëvizja jonë çlirimtare, me idetë e Adem Demaçit, Metush Krasniqit, Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës,

Nuhi Berishës dhe Rexhep Malës, Afrim Zhitisë, Fahri Fazliut, Zahir Pajazitit, për t'u trupëzuar në jetën dhe veprën e Komandantit legjendar Adem Jasharit, Hamzës, Fehmiut, Xhevës, Abesë, Luanit, Shkëlzenit, Mujës, Ilazit, Bedriut, Rasimit, Xhavit Hazirit, Hafir Shalës, Ukshin Hotit e qindra heronjve tanë, të cilët kishin marrë rrugën e lirisë, deri në vdekje.

Kjo ushtri, nuk ishte e frymëzuar nga revolta, sepse ajo ka karakter dhe qëndrueshmëri afatshkurtër. UÇK-ja ishte ndërtuar për luftë deri në çlirimin e vendit. Me kallash në dorë, kundër tankut, aeroplanit dhe prangave serbe, por nuk u thye. Nuk iu dëmtua morali. Sa më shumë bënte krime ushtarake e policia serbe ndaj qytetarëve tanë, aq më shumë shtoheshin radhët e UÇK-së. Pastaj dolën në skenë edhe miqtë tanë, shtetet mike të lirisë dhe demokracisë, miqtë e kombeve të shtypura që luftonin për të drejtat e veta, më në fund erdhi edhe te ndryshimi i opinionit botëror për luftën tonë. Kjo luftë i pati prijësit e vet. Të gjithë, pa dallim, u rreshtuam prapa komandantit legjendar Adem Jasharit, duke personifikuar një histori unike në botë, kur me tërë Jasharajt, në kullë baroti, lufton deri në vdekje, me tri gjenerata të familjes. Pas rënies heroike të komandantit legjendar, drejtimin e Luftës tonë çlirimtare e mori Drejtoria politike dhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Këtë e thotë edhe Feha në intervistën e parë si një nga drejtuesit e UÇK-së, për BBC. Kjo ushtri çlirimtare zuri vendin që i takon në agjendën e luftës, në mbrojtjen e civilëve pas masakrave që shpërthyen, ku me mijëra qytetarë u vranë dhe dogjën, u masakruan dhe dhunuan, duke kulmuar me bombardimet e NATO-s. Këtu dolën në skenë edhe emrat që historia i mori në mbrojtje duke i kurorëzuar dhe vendosur në vendin më meritore, me vlerën më të lartë të asaj përpjekjeje, me arritjen e lirisë së Kosovës dhe shpalljen e

Pavarësisë. Nuk duhet harruar se lufta jonë përjetësoi në histori shumë drejtues të luftës çlirimtare, sepse, ata ju prinin ushtarëve, nuk qëndronin në prapavijë. Ndërsa udhëheqësit tanë çlirimtarë që janë gjallë, armiqtë i dënuan, por, nuk i deshti plumbi. Këtu, Hashim Thaçi, prezanton dhe është personifikim i liderit në kohën e zhbërjes së kombit tonë, emër që shkëlqeu në kohën kur vendi ynë ishte një varrezë e madhe masive e shkaktuar nga okupatori serb. Sot, padrejtësia më e madhe që i bëhet shtetit dhe kombit tonë, është vlerësimi për një histori të luftës së drejtë çlirimtare, për një ushtri e bazuar mbi vullnetarët por veprimi konform ligjeve pozitive të luftës, për një histori suksesi të Republikës së Kosovës dhe NATO-s, për lirinë si vlerën më të madhe të qenies njerëzore. Hashim Thaçi dhe drejtuesit tjerë të UÇK-së që gjenden në Hagë, kanë qenë dhe janë përfaqësues të tërë përpjekjeve për liri dhe arritjen e lirisë, nga Skënderbeu e këndej, duke e pritur lirinë dhe duke drejtuar si burrështetas, Republikën e Kosovës. Ky gjyq, do të jetë goditja e fundit që mund ta bëjnë armiqtë tanë shekullor kundër shtetit, kombit dhe lirisë tonë, të drejtës tonë për liri dhe çlirim, të drejtës tonë t'i bashkohemi vlerave euro-atlantike, rrugës tonë të vetme. Me Thaçin dhe çlirimtarët, është çdo atdhetar i cili me gjenerata, për njëqind vjet u ushqye, kontribuoi dhe veprimi për çlirimin dhe shtetin e Kosovës. Të tillë janë shumë. Por, ishte e pritshme edhe për ndonjë heroizëm apo gjeneral pas luftës. Për fat të mirë, secilit i dihet vendi dhe roli në rrugën për çlirim. Fjalët sot, nuk i bëjnë më të bukura veprat e djeshme. Po, kur i filluam aktivitetet për çlirim, numëroheshim me gishta, për të marrë përkrahje nga gjithë bota demokratike dhe sot gëzojmë shtetin, ushtrinë, policinë, gjyqet dhe tërë vlerat e shtetit që ndjejnë mungesën e presidentit të saj, Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe drejtuesit tjerë të UÇK-së.

# Në Kosovë edhe 11 të vdekur dhe 720 raste të reja me Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) ka njoftuar të mërkurën se gjatë 24 orëve të fundit 11 pacientë me Covid-19 kanë vdekur dhe janë regjistruar 720 infektive të reja. Ky institut ka kryer 1,599 testime brenda 24 orëve. Që nga 13 marsi, kur në Kosovë janë shënuar rastet e para me Covid-19, 860 kanë vdekur dhe 31,215 janë infektuar



shënuar 469 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 18,347 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12,008.

Rastet pozitive janë nga Komuna Prishtinë 319 raste,

Gjilan 62 raste, Ferizaj 47 raste, Fushë-Kosovë 44 raste, Podujevë 33 raste, Mitrovicë 27 raste, Prizren 27 raste, Lipjan 23 raste, Pejë 18 raste, Vushtrri 14 raste, Skenderaj 11 raste, Viti 11 raste, Suharekë 10 raste, Kamenicë 9 raste, Malishevë 9

raste, Drenas 8 raste, Obiliq 7 raste, Kaçanik 6 raste, Klinë 6 raste, Gjakovë 5 raste, Rahovec 5 raste, Shtime 5 raste, Deçan 4 raste, Dragash 4 raste dhe me nga 1 rast komunat Graçanicë, Istog, Kllokot, Novobërdë, Zubin-Potok dhe Zveçan.

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 NËNTOR-** Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1,599 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 720 raste

pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me Covid.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Prizren katër raste (81, 79, 72, 72 vjeç), Istog një rast (51 vjeç), Klinë një rast (63 vjeç), Mamushë një rast (31 vjeç), Mitrovicë një rast (84 vjeç), Pejë një rast (70 vjeç), Prishtinë një rast (76 vjeç), Viti një rast (74 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 31,215 raste nga 123,976 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 860 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë

## Shënohet dita botërore për parandalimin e abuzimit të fëmijës

**PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)-** Qendra për Arsim të Kosovës (KEC) në partneritet me Qendra për Studime të Avancuara (FIT) për tri vite me radhë do të shënojnë "Ditën Botërore për Parandalimin e Abuzimit të Fëmijës".

Përmes një njoftimi për media thuhet se kjo ditë do të shënohet në kuadër të projektit "Së bashku kundër abuzimit të fëmijës - TACA", projekt i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR).

Ky projekt ka filluar të zbatohet në shkurt të vitit 2020 dhe ka për qëllim të sigurojë që të gjithë fëmijët të trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin



dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedis pa abuzim në shkollat e Kosovës.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Qendra për Studime të Avancuara (FIT) fushatën e

filluan duke mbledhur mesazhe dhe punime kundër abuzimit nga nxënësit e shkollave përfituese të projektit dhe duke i shpërndarë atonë faqe të internetit, duke dhënë

informacione rreth rëndësisë që ka kjo ditë dhe, duke krijuar partneritet me institucionet shtetërore që punojnë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Në vitin 2000, Fondacioni i Samitit Botëror të Grave (WWSF), një organizatë joqeveritare, shënoi Ditën Botërore për Parandalimin e Abuzimit të Fëmijës më 19 nëntor. Ky fondacion, së bashku me një koalicion ndërkombëtar të organizatave avokuese për gratë dhe çështjet e fëmijëve, mobilizuan qeveritë dhe shoqëritë për të ndërmarrë veprime dhe për të parandaluar abuzimin e fëmijëve. Në 2001, shumë shtete u bashkuan për të shënuar këtë ditë duke

kontribuar në dhënien e këshillave për identifikimin dhe parandalimin e abuzimit të fëmijës.

Kjo është një ditë e cila është në përputhje me përvjetorin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (20 nëntor) dhe, e cila ka për qëllim të jetë një pikë grumbullimi rreth çështjes së abuzimit të fëmijës dhe nevojës për programe urgjente parandaluese efektive. Në vitin 2001, koalicioni ndërkombëtar i OJQ-ve bashkoi 149 organizata në më shumë se 60 vende të botës. Secila organizatë shënoi Ditën me aktivitete dhe ngjarje lokale ose kombëtare. Në vitin 2009 fushata u zhvillua nga 785 organizata nga 127 vende nga e gjithë bota.

## Nis fushata e BE-së që thekson mundësitë e të rinjve në të gjithë Ballkanin Perëndimor


**PRISHTINË, 18 NË, 18 NËNTOR (ER)-** "#BE dhe TI - Historia jote, e ardhmja jonë!" është fushata e parë e integruar e zhvilluar nën European Union's Regional Communication Programme (Programin Rajonal të Komunikimit të Bashkimit Evropian) për Ballkanin Perëndimor. Fushata synon të promovojë mundësitë dhe përfitimet e ofruara nga programet e BE-së në dispozicion për të rinjtë në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi.

Këto përfshijnë fushat e arsimit, trajnimit dhe sportit (ERASMUS+), ato të sipërmarrjes (COSME - Competitiveness of Enterprises and Small and Medium-sized Enterprises), të kulturës dhe kreativitetit (CREATIVE EUROPE) dhe kërkimin dhe inovacionin (HORIZON 2020). Fushata është krijuar për të inkurajuar pjesëmarrje më të madhe në këto programe duke treguar histori suksesi, rezultate dhe përfitime.

Në prezantimin e eventit folës do të jenë drejtoresha për Ballkanin Perëndimor e

Komisionit Evropian, Geneveva Ruiz Calavera, ambasador i BE-së në Shqipëri Luigi Soreca dhe ambasador i BE-së për Bosnjë dhe Hercegovinë, Johann Sattler.

Eventi do të paraqesë gjithashtu gjashtë të rinj që do të tregojnë përvojat e tyre të pjesëmarrjes në një nga programet e BE-së. Sesioni përfundimtar do të marrë formatin e pyetje-përgjigjeve me gjashtë ambasadorë të rinj evropianë nga Ballkani Perëndimor të zgjedhur që më parë gjatë këtij viti.



# Osmani: Pjesëmarrja e grave në procesin e dialogut, vendim i nevojshëm dhe i mençur

Ushtruesja e detyrës së presidentes, Vjosa Osmani, ka thënë se aktualisht pjesëmarrja e grave në dialogun Kosovë-Serbi mbetet ende në nivele brengosës. Ajo ka thënë se pjesëmarrja e grave në procesin e dialogut është jo vetëm vendim i nevojshëm, por edhe vendim i mençur

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 NËNTOR- Ushtruesja e detyrës së presidentes, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në konferencën virtuale "E Ardhmja e Agjendës për Gratë, Paqen, Sigurinë dhe Drejtësinë në Kosovë dhe përtej".

Kjo konferencë po mbahet me rastin e 20-vjetorit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe me këtë rast u lansua edhe Rrjeti Mesdhetar i Grave Mediatorë (MEËMN) - Dega në Kosovë.

Duke i përgëzuar organizatorët dhe pjesëmarrëset për punën e

palodhshme për të avancuar angazhimin e grave dhe vajzave në procese të paqes, sigurisë e drejtësisë në Kosovë, u.d. presidentja Osmani ka theksuar që kjo konferencë, po ashtu paraqet një mundësi të mirë që të "reflektojmë dhe të identifikojmë se çfarë mund të bëjmë për t'i fuqizuar tutje veprimet tona në mënyrë që t'i përmbushim zotimet në kuadër të Rezolutës 1325".

"Gratë në Kosovë kanë qenë historikisht dhe vazhdojnë të jenë shtyllë e shoqërisë tonë. Mirëpo, roli i tyre shpesh është marginalizuar, vlerësimi i kontributit të tyre ka qenë më i zbehtë, e angazhimi i tyre në proceset e ditëve të sotme

vendimtare për të ardhmen e vendit tonë është ende larg niveleve të dëshiruara", ka thënë Osmani.

Duke vënë theks të veçantë në angazhimin e grave në dialogun Kosovë-Serbi, u.d. presidentja Osmani ka thënë se

aktualisht pjesëmarrja e grave në dialog mbetet ende në nivele brengosës. "E ne duhet të kemi të qartë që pjesëmarrja e grave në procesin e dialogut është jo vetëm vendim i nevojshëm, por edhe vendim i mençur, e mbi të gjitha, është një dëshmi e

përkushtimit për të respektuar objektivat e Rezolutës 1325", ka deklaruar Osmani.

Në këtë konferencë pjesëmarrës ishin përfaqësuesë të institucioneve vendore, ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare.

# Selmanaj shpreh pakënaqësinë për procesin e tejzgjatur të liberalizimit të vizave

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)- Zëvendëskryeministri i Kosovës, Driton Selmanaj, ka zhvilluar një bisedë virtuale me shefin e zyrës së BE-së në Kosovë, ambasadorin Tomas Szunyog dhe ambasadorët e BE-së në Kosovë, rreth riorganizimit të strukturave të ish-Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM).

Zëvendëskryeministri Selmanaj, njoftoi ambasadorët për nënshkrimin e Rregullores Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) nga Kryeministri Avdullah Hoti, si dhe përpilimin e Organogramit të ri të Zyrës së Kryeministrit.

Zëvendëskryeministri Selmanaj, ka potencuar se strukturat organizative të ish-Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) do të ruajnë



strukturën e tyre të plotë dhe funksionet të cilat i kanë ushtruar deri tani me qëllim të

ruajtjes së njohurive dhe përvojës që është zhvilluar ndër vite.

Gjatë kësaj bisede, zëvendëskryeministri Selmanaj ka theksuar faktin që zbatim i

Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA) dhe Agjenda e Reformave Evropiane (ARE2) janë tejet të rëndësishme për të siguruar rrugën e Kosovës drejtë integritimit evropian.

Selmanaj, po ashtu ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) si parakusht i nevojshëm për zbatimin dhe monitorimin efektiv të reformave dhe Planit të Veprimit për ARE 2. Zëvendëskryeministri Selmanaj, në fund të takimit shprehu pakënaqësitë e tij në lidhje me procesin e stërzgjatur të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ai ka theksuar se një rezultat pozitiv lidhur me liberalizimin e vizave do të hapte mundësitë për një qasje të ripërtirë në zbatimin e të gjitha reformave të domosdoshme për Republikën e Kosovës.

# Ngrihet aktakuzë për shpëlarje të parave

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kundër të pandehurve me iniciale B.T, Q.T, A.T dhe J.T, shtetas të Republikës së Kosovës.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka njoftuar se aktakuza është ngritur për shkak se është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë, se të pandehurit në bashkëveprim kanë kryer veprën penale "Shpëlarja e parave", nga neni 302 të KPRK-

së dhe ligjit nr. 05/L96 neni 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Në aktakuzë është propozuar edhe konfiskimi i pasurisë se paluajtshme, pronë e të pandehurve, e cila gjatë fazës se hetimeve ka rezultuar të jetë pasuri e fituar me vepër penale.



# Qelaj kërkon të mos zvogëlohet buxheti për Avokatin e Popullit

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)-Komisioni për Buxhet dhe Transfere ka votuar raportin vjetor financiar të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, Naim Qelaj derisa ka prezantuar raportin financiar për vitin 2019, ka theksuar se realizimi total i buxhetit është 92.5 për qind, ndërsa buxheti përfundimtar për paga dhe mëditje është 923 mijë euro. “Avokati i Popullit mandatin e vet kryesisht e realizon si mision të vetëm ku ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Numri i personave në ankesat që janë paraqitur janë 9,468 personave, numri i rasteve për hetime 943, numri i përgjithshëm i rasteve

të mbyllura për vitin 2019 është 849. Sipas procedurave kemi bërë deklarinimin e kursimeve prej 142 mijë euro. Realizimi total i buxhetit është 92.5 për qind. Sipas procedurave ligjore institucioni ka bërë deklarinimin për paga dhe mëditje prej 50 mijë euro, ndërsa buxheti përfundimtar për paga dhe mëditje është mbi 923 mijë euro”, ka thënë ai.

Qelaj ka paraqitur një shqetësim për buxhetin e vitit 2021, ku ka kërkuar që të aprovohet dhe të mosshkurtohet buxheti për këtë institucion me qëllim që ta realizon me sukses mandatin. “Me ndryshimet ligjore që janë bërë, mandatin të Avokatit të



Popullit i janë shtuar shumë obligime. Me qëllim të realizimit me sukses të mandatin, kërkojmë që kërkesa buxhetore të aprovohet dhe të

mos shkurtohet siç ka ndodhur. Për të ardhmen nuk është planifikuar rritje e pagave brenda institucionit tonë, por është paraparë shtim i stafit”,

është shprehur Qelaj. Deputeti i PDK-së, Bedri Hamza, ka kërkuar që të jenë racional dhe të arsyeshëm në kërkesat e Avoktit të Popullit.

# Pas dy vitesh hetimesh, hiqet ndalesa e fluturimit për Boeing 737 MAX



Uashington, 18 nëntor- Pasi gati dy vite hetimesh, probleme brenda korporatës dhe shumë mosmarrëveshje me

rregullatorë në shumë vende të botës, kompania Boeing ka fituar të mërkurën miratimin nga Administrata Federale e

Aviacionit në ShBA, që të lejojë përsëri fluturimet me avionin 737 MAX, pas dy katastrofave fatale.

Federata e Aviacionit ka njoftuar se kompania duhet të bëjë disa ndryshime softuerike si dhe ndryshime gjatë

trajnimeve në mënyrë që të rifillojë fluturimet pas një ndalesë 20-mujore, më e gjata në historinë e aviacionit komercial.

Në rrëzimet e dy aeroplanëve 737 MAX në Indonezi dhe Etiopi humben jetën 346 persona brenda pesë muajve në vitin 2018 dhe 2019 si dhe shkaktuan një stuhitë hetimesh.

Këto rrëzime i shkaktuan kompanisë Boeing humbje 20 miliardë dollarë amerikanë.

Avioni më i shitur i prodhuesit amerikan do të rifillojë shërbimin në një situatë kur bota po ballafaqohet me pandeminë e koronavirusit, tarifa të reja tregtare evropiane si dhe mosbesim ndaj kompanisë.

Familjarët e viktimave të rrëzimit të aeroplanit në Etiopi ka theksuar në një deklaratë të mërkurën se ata ndienin “zhgënjim të plotë dhe pikëllim” pas vendimit të autoriteteve amerikane për të kthyer avionin në shërbim.

Kompania ajrore amerikane United Airlines ka njoftuar se do t'i fus përsëri në përdorim fluturaket 737 MAX në fillim të çerekut të parë të vitit 2021 pas lejitimit nga autoritetet e aviacionit.

# Rukiqi takohet me një delegacion nga Tajvani, temë diskutimi bashkëpunimi ekonomik

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)- Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, është takuar të mërkurën me një delegacion nga Tajvani, me të cilët ka diskutuar rreth çështjeve ekonomike. Rukiqi përmes një postimi në

llogarinë e vet në “Facebook” ka bërë me dije se u pajtuan me delegacionin e Tajvanit për thellimin e bashkëpunimit ekonomik. “Me delegacionin nga Tajvani u dakorduam për intensifikim të bashkëpunimit ekonomik.

Shumë kompani nga Azia janë në kërkim të lokacioneve të reja për investime, sidomos në vende të cilat kanë kosto me të favorshme të fuqisë punëtore, përfshirë edhe Kosovën”, ka shkruar Rukiqi.





# Gërxhaliu: Involvimi i 'Guardia di Finanza', shpresë për zbulimin e krimit financiar



Njohësi i çështjeve ekonomike, njëherësh udhëheqës i Sekretariatit të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimore me seli në Trieste të Italisë, Safet Gërxhaliu, ka mirëpritur ftesën e ministres së Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami që "Guardia di Finanza" të bëjë zbardhjen e krimit financiar në zyrën e Thesarit

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 NËNTOR- Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, i cili është udhëheqës i Sekretariatit të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimore me seli në Trieste të Italisë, ka thënë se ftesa e ministres së Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami që "Guardia di Finanza" të bëjë zbardhjen e krimit financiar në zyrën e Thesarit, është shpresëdhënëse se mund të zbulohen edhe krimet e tjera financiare. "Kosova është duke u ballafaquar me sfida të shumta, një njëri anë pandemia Covid-19 dhe në anën tjetër pandemia ekonomike-sociale, e mbi të

gjitha ajo politike. Në këtë drejtim shumë qarqe të caktuara të krimit, të trashëguar nga e kaluara dëshirojnë të shfrytëzojnë këtë momentum të krijuar për qëllime të caktuara të grabitjes. Jemi dëshmitar të asaj se në Kosovë mungon sundimi i rëndit dhe ligjit dhe gjithashtu mungon transparenca. Pra, si shkak i kësaj tentohen të bëhen grabitje. Thirrja e ministres Hykmete Bajrami që "Guardia di Finanza" të bëjë hetim, është një rast eklatant dhe një shpresë e fundit për zbardhjen e krimit financiar në Thesar, aty ku u bë bartja e mjeteve më shumë se 2 milionë euro. Ftesa e Bajramit, dëshmon më së miri humbjen e besimit në institucionet vendore dhe nevojën e zbardhjes së krimit

që mund të ketë ndodhur edhe në të kaluarën, gjë që kjo është shqetësuese, sepse pos skandalit të fundit mund të ketë ndodhur edhe skandale të tjera", ka deklaruar për gazetën "Epoka e re" Gërxhaliu. Ai ka folur dhe për rolin e "Guardia di Finanza" dhe mundësinë e mbulimit të kostos financiare ndaj tyre. "Involvimi i 'Guardia di Finanza' ka një traditë jo vetëm në Itali por edhe në vendet e tjera për të zbuluar krimin e organizuar. Kjo është shpresëdhënëse, sepse kemi shumë rrugë, kanalizime dhe projekte të papërfunduar, ndërkaq për cilësi mos të flasim. Besoj se është koha e fundit kur duhet të kemi guxim për ballafaqim me krimin e

organizuar. 'Guardia di Finanza' është organizatë e specializuar që funksion në kuadër të OKB-së, dhe në këtë drejtim kredibiliteti i saj nuk duhet të vihet në dyshim por ne duhet të jemi të përgatitur", ka thënë ai. Gërxhaliu ka thënë se Kosova ka donatorë të ndryshëm që e mbështesin në forma të ndryshme, dhe sipas tij, kostoja për t'u angazhuar "Guardia di Finanza" mund të mos se prekë direkt buxhetin e Qeverisë së Kosovës. "Kjo mund të mbulohet në forma të ndryshme, qoftë nga donacionet nga Bashkimi Evropian në bashkëpunim me Qeverinë e Italisë", u shpreh ai. Më 6 tetor 2020, "Gurdia di Finanza" bashkë me ambasadorin italian në Kosovë, Nicola Orlando kanë vizituar Ministrinë e Financave dhe Transfereve. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të ATK-së, Doganave dhe të Njësisë së Inteligjencës Financiare. Ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami, ka

bërë me dije se në këtë takim kanë biseduar për një projekt të mundshëm në mes "Gurdia di Finanza", ATK-së, Doganës dhe NJIF, projekt ky që do të finançohej nga BE-ja. "Qëllimi i këtij bashkëpunimi është luftimin e evazionit, informalitetit, kontrabandës, pastrimit të parave dhe aktiviteteve tjera të kundërligjshme që dëmtojnë financat publike. Në atë takim jemi pajtuar që institucionet tona të identifikojnë fushat ku dëshirojnë bashkëpunim, gjë të cilën e kanë bërë me kohë. Pas vjedhjes në Thesar, në cilësinë e Ministres së Financave i kam dërguar letër ambasadorit Italian, që në fusha të bashkëpunimit të përfshihet edhe Thesari, me theks auditimi në Thesar, por edhe ngritja e nivelit të sigurisë dhe integritetit të sistemit. Njëherësh kam kërkuar nga ambasadori i BE-së z. Tomas Szunyog edhe mbushjen financiare nga BE që 'Gurdia di Finanza' të auditojë Thesarin", ka deklaruar ministrja Bajrami.

## Dështon të shqyrtohet në Komisionin për Buxhet Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)- Komisioni për Buxhet dhe Transfere nuk i ka dhënë mbështetje Projektbuxhetit 2021 pasi nuk pati vendimmarrje në votim. Deputetët e Vetëvendosjes (LV) dhe Partisë Demokratike

të Kosovës (PDK) edhe pse ishin prezentë nuk kanë votuar. Për shkak të mos vendim marrjes, Komisioni ka shtyrë për një mbledhje tjetër votimin për Projektligjin e rimëkëmbjes ekonomike. Në fillim të

muajit nëntor, ka dështuar të mbahet seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit, ku ishte paraparë të hidhet në votim për lexim të dytë ky projektligj. Seanca dështoi në mungesë të kuorumit.



## Ali Berisha: Arbër Grabovci, alternativa për Pejën

PEJË, 18 NËNTOR (ER)-Nënkryetari i AAK-së, njëherësh edhe deputet në Kuvendin e Kosovës, Ali Berisha e ka vlerësuar lartë kandidatin për kryetar të Pejës, Arbër Grabovcin. Ai ka thënë se qytetarët e Pejës nuk mund të durojnë më arrogancën, injorimin dhe mashtrimin në këtë qytet nga qeverisja e tanishme. "Peja dhe qytetarët e Pejës nuk e durojnë arrogancën, injorimin dhe mashtrimin.

Pushtetarët e korruptuar komunal sakrifikojnë dhe i linçojnë bashkëpunëtorët, vetëm e vetëm që ta shpëtojnë vetëveten. Për mashtrimet e bëra, fajet mundohen t'ua hedhin të tjerëve. Kësaj mendësie të qeverisjes po i vije fundi. Qytetarët e Pejës po e formësojnë alternativën. Prof. Arbër Grabovci do të jetë alternativa", ka shkruar Berisha në llogarinë e vet në "Facebook".



## Haziri: Po kalojmë ditët më të vështira me pandeminë



GJILAN, 18 NËNTOR (ER)-Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, pas takimit të Komitetit të Emergjencave, ka thënë se kalojnë ditët më të vështira të përbaljes me pandeminë e pamëshirshme. "Fatkeqësisht, brenda 24 orëve e kemi humbur edhe një bashkëqytetar dhe i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes. Kufizimi i lëvizjes po respektohet sikurse edhe nga ana e gastronomisë. Besoj që

me solidaritet do ta përballojmë këtë situatë e vështirë", ka thënë Haziri, në konferencën për media. Ai ka pohuar se përkundër rritjes së numrit të rasteve pozitive, në Gjilan gjendja është nën kontroll, duke shtuar se të gjitha rastet që janë të infektuar, janë në monitorim të plotë 24 orë e shtatë ditë. Në këtë konferencë ka folur edhe drejtori klinik i Spitalit të

Përgjithshëm, dr. Ukshin Ismaili, dhe drejtoresha e QKMF-së, dr. Arbenita Hajdari, të cilët kanë apeluar te qytetarët që të kujdesen për vetën, ta bartin maskën. Gjendja e përgjithshme në Gjilan është kjo: Nga 6063 mostra, 2164 persona kanë rezultuar pozitivë, 1528 janë shëruar, 573 raste aktive, 63 të vdekur, 66 të hospitalizuar dhe 180 mostra në pritje për rezultat.

## Në Gllamnik të Podujevës po ndërtohet kolektori për ujëra të zeza

PODUJEVË, 18 NËNTOR (ER)-Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Faik Muçiqi, ka vizituar fshatin Gllamnik, ku janë duke u kryer punimet për ndërtimin e kolektorit.

Kolektori, i cili po ndërtohet, do të bëjë grumbullimin e ujërave të zeza të disa lagjeve dhe do t'i përcjell në kolektorin kryesor. Nënkryetari Rudari u shpreh i kënaqur me dinamikën e kryerjes së punimeve, sipas planit të paraparë.



## Përurohët objekti i ri i Urgjencës në Malishevë

MALISHEVË, 18 NËNTOR (ER)-Në Komunën e Malishevës është bërë përrurimi dhe fillimi i punës në objektin e ri të Urgjencës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Në ceremoninë e përrurimit e këtij objekti kanë marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, drejtori komunal për Shëndetësi, Liridon Hoti, zyrtarë të qeverisë komunale dhe stafi i QKMF-së në Malishevë. Me këtë rast, Berisha ka thënë se ndërtimi i objektit të urgjencës është njeri prej projekteve më të rëndësishme të Komunës së Malishevës. "Urgjenca në QKMF është një prej hapave

më të mirë që është bërë, pasi është një objekt që i ka munguar QKMF-së, dhe janë bërë shumë përpjekjeve për ndërtimin e saj. Uroj të ketë sa më pak punë, por edhe kur ka punë, e ka hapësirën e nevojshme për punë dhe krejt kjo është meritë e angazhimit të të gjithë juve profesionist shëndetësorë", ka thënë nënkryetari Berisha. Ndërsa ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka përgëzuar Komunën e Malishevës për ndërtimin e këtij objekti me rëndësi për shëndetësinë e kësaj komune. "Avancimi i shërbimeve shëndetësore është prioritet i qeverisë dhe ministrisë, përfshirë edhe Malishevën. Ky objekt që ofron kushte më të mira, lehtëson punën e profesionistëve shëndetësorë



dhe rrjedhimisht ofrohet shërbim më i mirë për të gjithë ata që kanë nevojë", ka thënë Zemaj. Edhe ministri Vesel Krasniqi

ka thënë se Urgjenca është një mundësi më e mirë për stafin mjekësor, por edhe për ata që kanë nevojë të trajtohen këtu.

Ndërtimi i objektit të Urgjencës është mundësuar nga buxheti i Komunës së Malishevës dhe ka kushtuar rreth 270 mijë euro.

# MES MOSPËRFILLJES, KUSHTËZIMIT DHE INJORANCËS (2)



**Shkruan: Agron HOTI**

Ekonomisë së Kosovës i kanë ndodhur tetë të këqija të mëdha, pasojat e të cilave do t'i vuajmë edhe për një kohë të gjatë, ato janë: 1. Së pari dhe gjithmonë së pari, po harrohet fakti se Serbisë sikur mos t'i mjaftonte terrorizimi dhe eksploatimi i pamëshirshëm i Kosovës që prej Luftës e Dytë Botërore, ajo krahas gjenocidit dogji pothuaj tërë Kosovën gjatë luftës 1998-1999. Të rralla janë ato shtete në botë, të cilat kanë pasur histori të ngjashme me Kosovën dhe që kanë mundur ta rimarrin veten për t'u bërë sadopak konkurruese për vetëm 12 vjet shtet. Kosova nuk ishte as Gjermani e as Japoni, për të rimarrë veten dhe për t'u bërë ekonomi e fortë rajonale. Kosova nuk ishte as Zvicër, në territorin e së cilës terrori e lufta nuk kanë gjetur vend me qindra vite. Harrohet fakti që Kosova (ashtu sikurse tërë shqiptarët) ishte vendi më i varfër dhe më i pashkolluar në Evropë. Derisa Evropa në vitin 1998-1999 po bënte plane për thellimin e integritetit të saj, Kosova pikërisht në këtë periudhë po luftonte për bukë dhe ekzistencë, kaq ishte dallimi për ata që kanë harruar. 2. Së dyti, nuk mund ta heshtim faktin që pas vitit 1999 korrupsioni, përvetësimi i pasurisë kombëtare dhe promovimi i injorancës në shkallë të gjerë nga politika e Kosovës, kush më shumë e kush më pak, ka qenë dhe ende është pengesë e madhe për zhvillimin e synuar ekonomik dhe jo vetëm. Nuk ka pasur përpjekje e asnjë vizion vendor për ringjalljen e

atyre uzinave e fabrikave që patën ekzistuar në Kosovë. Përvetësimi i mijëra hektarëve prona me çmime qesharake dhe tentimshitet e tyre me çmime astronomike kanë qenë dhe janë pengesë serioze për joshjen e investitorëve të huaj dhe diasporës tonë të madhe. Kjo sepse çdo investitor në botë nuk është i interesuar të blejë apo marrë me qira prona me çmime astronomike, ndërkohë që shtete tjera në rajon dhe botë i japin ato me çmime skajshmërisht më të favorshme se sa Kosova.

3. Së treti, edhe pse pati një iniciativë në vitin 2005 dhe 2006 për hartimin e një Plani Kombëtar për Zhvillim të Kosovës, ajo tentativë dështoi. Përgjegjësia bie plotësisht mbi UNMIK-un, i cili kishte fjalën kryesore për çdo gjë duke pasur pothuaj pushtet absolut në Kosovë. Nuk ishte i interesuar UNMIK-u që Kosova të nxirrte një dokument strategjik përmes të cilit Kosova e pa-shtet do të dukej si shtet, dhe i cili plan do t'u jepte orientim politikave zhvillimore të Kosovës dhe ashtu ndodhi në fakt.

4. Së katërti, nuk pati kurrfarë përpjekje nga UNMIK-u që të ndalej deindustrializimi ose që të fillonte revitalizimi industrial i Kosovës, p.sh. nuk do të ishte shumë problematike që, ndër të tjera, të ri-aktivizohej fabrika për prodhimin e sheqerit në Pejë dhe në përgjithësi industria e agro-përpunimit, kur lënda e parë fare lehtë do të mund të sigurohej nga tokat e Kosovës ashtu siç mund të sigurohet edhe sot po të kishte vizion për zhvillimin e kësaj industrie. UNMIK-u e futi Kosovën në CEFTA (shih më poshtë) duke e dekurajuar bujqësinë dhe industrinë e agro-përpunimit, si resorin e vetëm zhvillimor, të cilin e kishte në dispozicion Kosova. Edhe pse në marrëveshjen e CEFTA-s është e lejuar që palët negociuese të vendosin kuota për produkte të caktuara, me qëllim që të

mbrojnë prodhuesit vendor, Kosova nuk ka bërë një gjë të tillë sepse ishte UNMIK-u ai që dekurajonte një gjë të tillë. E kjo qysh në start të hyrjes në CEFTA paraqiti problem të madh për prodhuesit vendorë, të cilët nuk ishin konkurrent në tregun e tyre, ndërkohë që produktet e importuara ofronin çmime më konkurruese. Nga ky dekurajim i bujqësisë dhe industrisë së agro-përpunimit, që bazën e ka te CEFTA, as sot nuk kemi mundur të dalim.

5. Së pesti, privatizimi i ndërmarrjeve publike u bë në mënyrën më të dëmshme ekonomike të mundshme sa që kontribuoi fare pak në zhvillim ekonomik të vendit. Asnjëherë UNMIK-u nuk hartoi një Strategji Privatizimi, e cila do t'i jepte orientim ekonomisë së vdekur të Kosovës. Në vend të politikave UNMIK-u krijoi Agjencinë e Privatizimit duke u futur menjëherë në zbatim të privatizimit pa politika e strategji siç rëndom e kërkon çdo zhvillim në një vend. Ç'është e vërteta, nuk është se ngriti kush zërin nga politika e Kosovës për këtë çështje jetike për të ardhmen ekonomike të vendit. Në vend që privatizimi të ruante destinimin e asaj industrie që ishte dhe të kthente mundësisht tregjet, ai i shndërroi shumicën nga ato uzina në depo tregtare, të cilat përfunduan në duart e politikës tërësisht jo-inovatore, jo-vizionare dhe jo rrallë injorancë-promovuese të Kosovës, diçka që vazhdon edhe sot me ritme pothuaj të njëjta.

6. Së gjashti, UNMIK-u nuk bëri as edhe një politikë të vetme për pronat, keq-menaxhimi i të cilave kontribuoi në ngulfatjen e zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe këtu sikurse të privatizimi nuk u hartuan politika e Strategji për Prona, përmes së cilës do të mundësohej shfrytëzim sa më produktiv i tyre, por vetëm u themelua një Agjenci e Pronave, e cila nuk kishte kurrfarë linjash

orientuese se kah do të duhej të shkonte prona e Kosovës. E spektri politik i Kosovës, përpos garës së për përvetësim të pronave – të cilat nga sistemi jugosllav ishin shtetëzuar me dhunë e terror ndaj shqiptarëve – nuk kishte shprehur ndonjë interes të shfrytëzimit të pronave në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Siç e thashë më lartë, çmimet astronomike të pronave të përvetësuara përmes privatizimit janë tejet dekurajuese për ardhjen e investitorëve të huaj dhe pse jo arsenalit të madh të diasporës tonë.

7. Së shtati, UNMIK-u në pothuaj në të gjitha dimensionet e qeverisjes instaloi ashtu siç instaluan misionet e OKB-së në tërë botën - korrupsionin dhe injorancën; ka pasur me qindra raste kur UNMIK-u në administratë publike kishte marrë njerëz me dhe pa shkollë të mesme para atyre me shkollim superior. Pastaj, mega-aferrat korruptive të përfaqësuesve të UNMIK-ut ishin konstante. Nuk është që pastaj edhe spektri politik vendor nuk e vazhdoi lojën e korrupsionit dhe promovimit të injorancës, diçka që po vazhdon edhe sot.

8. Së teti, futja e Kosovës në CEFTA (Central European Free Trade Agreement) në vitin 2007 pa asnjë debat të gjerë publik dhe pa asnjë analizë të mirëfilltë ekonomike ishte shkatërruese për të ardhmen ekonomike të Kosovës, sepse kushtet në të cilat hyri Kosova ishin tepër të pafavorshme për ekonominë e saj pothuaj të vdekur. Nuk u bë asnjë kost-benefit analizë për të bindur qytetarët e Kosovës se hyrja në CEFTA do të ngjallte ekonominë pothuaj të vdekur të Kosovës, e sidomos bujqësinë dhe agro-përpunimin ku Kosova do të mund të kishte avantazhe. Nëse CEFTA, origjina e së cilës rrjedh nga marrëveshja e 21 dhjetorit 1992 mes vendeve të Vishegradit në përbërje të

Polonisë, Hungarisë, Çekisë dhe Sllovakisë, kishte për qëllim përafrimin e Evropës Qendrore me atë Perëndimore, kjo ishte e mundshme atje, sepse asnjëri prej këtyre vendeve nuk kishte kaluar nëpër luftë gjatë rënies së komunizmit siç kishin kaluar hapësirat jugosllave, me theks të veçantë Kosova, e cila ishte shkatërruar dhe djegur shumica e saj. Pra, nëse Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia hynë si goxha të barabarta ekonomikisht në CEFTA, Kosova hyri në CEFTA me një Serbi, e cila përpos që ishte dhe vazhdon të jetë agresore dhe destabilizuese e rajonit, kishte një epërsi të theksuar ekonomike krahasuar me Kosovën dhe rajonin, diçka që vazhdon edhe sot.

Ndërkohë që, injektimi i CEFTA-s në hapësirat e ish-Jugosllavisë së hasmuar me luftëra të përgjakshme nuk mund të kishte efektet e njëjta sikurse në Evropën Qendrore, sepse shpërbërja e Jugosllavisë ishte bërë me gjashtë luftëra duke filluar në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Kosovë, Kosovë Lindore dhe Maqedoni. Ndërkohë që hapësirat shqiptare, edhe ashtu më të varfërat në Jugosllavi, ishin më të papërgatiturat për hyrje në Zona të Tregtisë së Lirë siç qe CEFTA. E kur një ekonomi praktikisht e vdekur futet në Zonë të Tregtisë së Lirë, atëherë pasojat e asaj ekonomie do të jenë fatale për vendin, ashtu edhe siç në fakt ndodhi me ekonominë tonë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, eksportet e Kosovës në vitin 2001 ishin vetëm 10.5 milionë euro, kurse importet afër 700 milionë euro në vit. Që lë të kuptohet se në vitin 1999 dhe 2000 eksportet ishin pothuaj zero. Ndërkohë, që në vitin 2006 eksportet e Kosovës ishin vetëm 110 milionë euro, kurse importet 1.3 miliard euro, pra kishim bilanc tregtar tejet negativ. (VIJON)

## Komuna e Ferizajt do të ndajë dru për familjet skamnore

**FERIZAJ, 18 NËNTOR (ER)**-Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, këtë të mërkurë ka mbledhur anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, për diskutuar pikat e rendit të ditës që janë përgatitur për diskutim. Drejtoresha e Financave Sebahate Ajeti-Sadiku, para anëtarëve të KPF-së ka bërë propozim-vendim për harmonizimin e investimeve kapitale dhe transferin në kategorinë ekonomike

dhe shpenzimet kapitale. Ndërkaq nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Artan Gavazi, ka bërë propozim-vendim për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet skamnore.

Sipas tij është një sasi prej 200 metrave hapësinor të cilat janë konfiskuar nga Drejtoria e Bujqësisë-Njësia e Pylltarisë në Ferizaj.

Për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, drejtoresha e Administratës së Përgjithshme,



Aurora Ramadani, ka përgatitur edhe dy propozim-vendime, atë të Kodit të Etikës si dhe Rregulloren për organizimi, funk-

sionimi dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Ferizajt. Në këtë mbledhje kaloi edhe propozim-vendimi për aprovimin e Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve.

U diskutuan edhe disa propozim-vendime për rishqyrtim, nga ana e drejtorit të Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit, Sabri Murseli.

Në këtë mbledhje drejtori i Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit, Sabri Murseli, ka propozuar edhe formimin e komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Në këtë komision do të jenë dy anëtarët të propozuar nga kryetari i Komunës, Agim Aliu, dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike si dhe një anëtar nga sektori joqeveritar lokal.



Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi (lartë), Gjergj Fishta dhe Asdreni (ulur)

## Gjergj Fishta, vazhdimtar në mendimin e kombit

**Nga: Lasgush PORADECI**

Fryma, Parim i perëndishmë që përpara herës, Mendim krijonjës dhe përmbajtës i bërë fjalë për të urdhëruar të-vetat, qëndroj, si në fillim të qënies, mi faqen e valëve në fillim të Ringjalljes shqiptare. Ky ish Mendimi Kombëtar, Fryma, përmbushëse e destinit të një Kombi. Ishte Shpirti i përmbajtjes që u bë Fjalë dhe njeri për t'u lajmëruar. Me këtë Frymë në gojë, Parim jetëdhënës, u dërguan Dërgimtarët shqiptarë në botën shqiptare, lajmëtarët e Mendimit të Kombit.

Ç'ishte ky Mendim-Frymë, Fjalë, Parim drite i pavdekur? Ish Mendimi i vetëdijës. Fjala e jetës shqiptare. Ajo ndrit errësirën dhe hap të fshehtë e punrave. Gjen dhe shpall të Vërtetën. Bisedon, për të njohur të Vërtetën shqiptare, edhe Zotin vetë, të Cilin e parashtron kombëtarisht mi tryezë. Dhe gjen pra kësisoj prej ndarjes dhe përçarjes së vjetëruar për të perënduar besimtare, bashkimin kombëtar më fenë dhe më Zotin.

Ky ish Mendimi i bërë Fjalë në gjuhën e Dërgimtarëve të Kombit, të atyre që paragatitnë Rilindjen, të atyre

që e ndërtoan, dhe të atyre që e vazhduan me Frymën e parë, e cila do të mbetet, siç është, e përgjithnjëshme. Me këtë Mendim në zemër e në gojë u vërsulën drejt qiellit të Kombit, si Parathënës të perëndishmë, Naum Veqilharxhi në Rumani, Efthim Mitkua në Egjipt, Anastas Kullurioti në Greqi, Harallamb Koçi në Rusi, me gjithë vargun e bashkëvallenarëve brënda dhe jashtë Atdheut. Me këtë Mendim, Mendim të Kombit në zemër e në gojë, muar hov Dërgimtarët e Frashërit, në ballë Naim Frashëri, Pashko Vasë Pasha Shkodrani, Mihal Gramenua, ndërtimtarë të Rilindjes. Me këtë Mendim vetëshugurohet At Gjergj Fishta vazhdonjës në udhën e Dërgimtarisë shqiptare.

Vjershëtori Naim Frashëri, një bektashi shqiptar, puth Krishtin në emër të Kombit dhe dyke e adhuroar lajmëron përmbledhjen e madhe të Shqiptarëve në Fenë e përbashkët të atdhedashurisë. Fjala e tij, është Fryma, Parimi, Shpirti i përjetshëm i Dërgimtarisë shqiptare:

*Djalëth njeriu i Perëndisë,  
Zot, ti ke vuar.  
Dhe dashurinë e bërë besë,  
Të qofsha falë!*

Diplomati Pashko Vasa, një katolik shqiptar, sodet vetëveten për të gjetur Mendimin e Kombit, dhe dyke e gjetur lajmëron gas të rëndë, në atë Vajën e tij që është vërtet Himni i math shpëtimtar, marshi bashkonjës i fateve shqiptare në Mendimin e Kombit, në Fenë e përbashkët të Shqiptarisë:

*Çohni, Shqiptarë, prej gjumit çohni,  
Të gjith si vllazën në një bes shtërgohni  
Edhe mos shikoni kisha e xhamija,  
Se feja e Shqiptarit asht Shqiptarnija.*

Kryengritësi Mihal Grameno, një orthodhoks shqiptar, këndon vjershëtorët dhe dëgjon veteranët, mëson Mendimin e Kombit dhe shpall Shpirtin, Vëllazëri e pandarë, Fe kombëtare:

*Njeri ne kisha, tjetri ne xhamija,  
Jemi vëllazër, s' na ndajnë dot.*

Edhe prifti Gjergj Fishta, Vazhdimtar në udhën e Kombit, Frymëtar i Fjalës, solli Dhuratën e vet në Adhurimtoresh e Atdheut-Shpirt, Mendim i Parathënësve të Shqipërisë. Ay e solli me gjithë vargun e shprehjeve

bashkimtare dhe vëllazërimtare fetare të falura në gojë të polemës shqiptare dhe të krerëve shqiptarë dhe të udhëheqësve shqiptarë, të cilët lidhin besë e fe shqiptare ndaj Rezikun- Mendim i kombit, Parim atdhedashurije. Më shumë, sepse dyke bërë dorëzim pavdekësisë, ay i-a pruri dhuratën Lahutës së tij me kombëtarësimin e fatosit shkodran Oso Kuka, të Ali Pashë Gusinjes dhe të Hajrijes në pavetëdije, të ridhënë Atdheut përngahera nga humbja e mosqënies. Vepërimi krijimtar i Gjergj Fishtës, i këtij krijimi kombëtar të vetëdijshëm prej kombësisë shqiptare së pavetëdijëshme, është ay i endjes, së pari, nëpër Purgatorin e vetëvetes spatronjës, ay i faljes në Adhurimtoresh e Mendimit të Kombit. Si një kushtrimtar i vyer për punën e kushtimit të tij, m'a pat bërë Fishta, vetë ay me gazin e fjalës së vet, këtë Apokalipsë të madhe shqiptare. Vajta t'a shoh rishtas më 1937, në Shkodër në Kuvend. S'e gjeta... Ardhi më mori... Folmë mi mjeshtëri të vjershës në atë tryezë përallore. Në librën t'ime të falur, i kisha shkruar pjesën e njëqindtë nga ç'desha:

*Njeriut të Zotit meditans dhe militans,*

*Burrit shqiptar përfaqësonjës,  
Më të madhit epik të shekullit.*

Si shpërblim fisnikërije për këtë të vërtetë, Fishta më përkëdheli toskërisht: "Lasgush, unë mirë të lexoj, mirë kuptoj. Ajo mënyrë e brëndshme është mundim, vajtje. Edhe unë do të mundnja të shkruaj ashtu, veç se druhem...". "Pater, shkruaj passi e kam mundur dhëmbjen dhe vajtjen, passi jam pastruar- në kujtim...". Atëhere Fishta pohoj dyke u zbuluar: "Vërtet, kam bërë unë kështu me Oson, Alinë, Hajrijën...", M'a shpjegoj pastaj i çelur në zemër atë vepërim kureshtjeje të fshehtësirave të punëtorisë vjershëtoresh, që është fshehtësija e forcës dhe e fuqisë së racës shqiptare, atavizma dhe dinamizma e gjakut shqiptar, Frymë, Parim, Fjalë e përjetëshme e Mendimit të Kombit.

Një prift tjetër, Fan Noli, Dërgimtar shpirt Dërgimtar i Shqipërisë, bëri më vonë prej këtij Mendimi të Kombit Mendimin e Flamurit të therrorisë dhe të Bashkimit të shentë kombëtar:

*Flamur! që linde Shën-Kostandinë!  
Bashkon Islamnë me Krishterimnë!  
Flamur: altar për therrori!*

# Faik Konica – themelhedhës i eseistikës shqipe

Nga Behar GJOKA

Një nga punët e vjera, të mbaruara për mbrekullji, nga Faik Konica, është formësimi dhe shpallimi i eseistikës, si thënie e përkryer e një mendje të ndritur euriditi. Një nga përcaktimet e bëra rreth figurës, nga Kujtim M Shala, në librin Elipsa, shprehet: Konica i dha fund një modeli kulturor/letrar: himnizmi, dhe nisi një tjetër: modeli kritik, përfundim natyrën dhe rolin e tij, përmasën dhe kontibutin, në rrafshet kreative, qoftë edhe në lamin eseistik. Ndërkaq eseistika e materializuar mjeshhtërisht, përfaqëson majën më të lartë, të veprimtarisë mendore dhe krijuese të kësaj figurë të historisë moderne, që komunikon dhe ndërkomunikon sot e gjithë ditën. Vështrimi i kësaj ane të kontributeve të Konicës, në lamitë e shumta të kulturës, varësisht lavrimit e esesë, shtron për shqyrtim disa çështje:

a – Tipologjia eseistike, tiparet më të rrokshme të kësaj forme ligjërimit.  
b – Eseja dhe eseistika, në kohët moderne ka fituar hapësira më të mëdha.  
c – Kontributi i Konicës, në shkrimin eseistik.  
d – Rrënjët e shqiptimit eseistik të autorit.

Nëse për çështjen e parë do të përmendim kuptimin e termit, nga frëngjishtja *essai* = tentim, sprovë. Eseja është një shkrim i shkurtër në prozë, ku zakonisht shprehen qëndrimet personale për çështje nga jeta, morali, shkenca, arti, politika etj. Sipas Sabri Hamitit, në librin Faik Konica: Jam Unë: Eseja është formë shkrimi e patrajtë (ku mungesa e trajtës është vetë trajta eseistike, që buron nga bashkëlidhja e letrares me joletraren- shënim imi), që njeh më parë impulset e krijimit se sa kufijtë e konventës dhe është forma më e përshtatshme për shpirtin krijues dhe kërkues, ku shkrepi idetë e pastra pa u lodhur të gjenden të gjithë argumentimet. Megjithatë, eseja duke qenë një trajtë unike, që ngërthen dhe përjashton trajtat e ligjëratave, letrare dhe joletrare, përçon maksimalen e shenjës estetike dhe logjike. Në këtë rast, këmbëngulja e Kantit, teksa vëren se: “Një gjykim shijeje që nuk ndikohet nga hijeshia apo emocioni ... dhe ku si tipar përcaktues është thjesht qëllimësia e formës, është gjykim i kulluar i formës”, na ndihmon sadopak për të depërtuar në hapësirat tekstologjike të eseistikës, që bart kjo enciklopedi e pashoqe e kulturës sonë.

Rreth çështjes së dytë, po sjellim një pjesë të historisë, që zë fill me (Michel de Montaigne) i pari që e përdori termin, në vitin 1580. Megjithatë, formën e esesë e gjejmë te Sokrati, Platoni, Theofrasti, Ciceroni etj. Ndërmjet shekujve 16 dhe 17-të, shquhet Frensis Bekoni, ai e quante esenë si “figuracion që jep më shumë oreks se sa ngopje”. Eseja mori një pamje moderne të autorit: Xhon Miltoni (1608-74), John Drydeni (1631 1700), Dr. Samuel Xhonsoni (1709-1784). Në Gjermani eseistika lulëzoi me Shilerin (1759-1805), vëllezërit Shlegel, nga Hajnrih Hajne. Në shekullin e 19-të, dallojmë

esetë e Saint-Beuve-it, Brander-it, Lemaître-it etj. Në shekullin 20-të shfaqen: E. M. Forsteri, Virginia Vulf, T. S. Elioti, Xhorxh Orvelli, Stefan Cvajgu, Andre Zhidi etj. Vihet re se, në shkollat moderne, krahas shtimit të hapësirave të lëvrimit të eseistikës, vështrimi eseistik i realitetit letrar, me gjasë vatra e shkrimit artistik, sa vjen dhe zgjeron praninë në letërsi. Në historinë e shkrimit të esesë, sërish jemi më të vonuar se letërsitë e tjera, por fatlumnia e pranisë së esesë të Konicës, e vunë mbë udhë të mbarë dhe në një hap me shoqet e tjera, këtë lami të shkrimit letrar dhe joletrar.

Pa asnjë dyshim, çështja e tretë, që ka të bëjë me shkrimin e esesë, me hedhjen e themeleve të eseistikës, si një kreativë e realizuar, me cilësi nga Konica, shënon vatrën kryesore të qëmtimit tonë. Duke qenë një pikësnyim i shpallur, që përbën pikën nevalgjike, qëllimin e kësaj ligjërate, në veprën shkrimore të Konicës përheri e vlen të hedhësh një vështrim, në kontributet e shumëfishta, pra eventualisht mbi tekstet e sendërgjuara si ese, që ndan tradicionalen nga modernia. Kjo shenjë unike dhe përtrimëse, e njeriut dhe kombit shqiptar, jo rastësisht vjen prej pendës së lakmueshme, në stil dhe formë, fjalë dhe vokacion. Përcaktimi i numrit të teksteve, pra janë pesë apo më shumë ese, mbase pavarësisht tematikës, llojit dhe shprehësisë, në të gjitha rastet, thelbësore është marrëdhënia që vendoset me këto tekste. Sugerimi i T. Todorov: “Nuk ka gjë më të zakonshme se përvoja e leximit dhe nuk ka gjë më të shpërfillur.” (2000: 165), tek libri Poetika e prozës, zbulon dy anë të medaljes, se pa lexuar tekstet esetë, nuk kemi asnjë mundësi të rrokim idenë fillestare të autorit. Po kaq, leximi dhe leximtarja, pavarësisht se janë diturake, akademike dhe të zakonshme, nuk shpëton dot nga rrahët e subjektivitetit (ngasjes se u tha fjala e mbrame, ndërkohë që e para dhe e mbramja fjalë i mbetet shkrimtarit), pra të shijes personale. Në një kuptim të ngushtë, jo si dije diturake, por si nevojë e komunikimit, me tekstet letrare dhe joletrare, të gjitha llojet e leximit, në këtë rast të eseistikes së Konicës të shpien kah Konica, për të zbuluar, rizbuluar dhe për të vënë re vatrën e paqëmtuara. Sprovat, si veprimtar dhe kërkues, në punët e shtetit, të kulturës dhe kombit, të fjalës dhe të letërsisë, të përkthimit dhe të gazetarisë, bën që kur mori pendë dhe kartë në dorë, për të shkruar esetë e famshme, të kishte pjekurinë dhe shijen e majtë, për të vënë themele të palëkundura, të llojit të esesë në gjuhën shqipe. Midis teksteve të shkruara si ese, do të mjaftonte eseja Shqipëria si m'u duk, për të krijuar një mendim për aftësitë shkrimore të Konicës në këtë rrafsh të ligjërimit, ku bashkëshkruhet letrarja me joletraren, shpirtërorja me logjiken. Mjeshhtërisht, në të pesë esetë, kapen aspektet më shqetësuese të kohës, lëngata e shoqërisë, në kapërcyell të shekujve, kryhet një operacion, etik dhe estetik, mbi sëmundjet e shoqërisë së kohës, derdhur në tekstet e autorit. Në tekstet eseistike të Konicës, simbas K. M. Shalës, vihet re se: Domeni është historia,



zhanri – esja, duke hedhur vështrimin në frymën dhe tipologjinë e shkrimit. Po nga Shala vjen përfundimi: Eseja është zhanër modern në diskurset historiografike. Ky zhanër, përpos që bart informacion, përpos diskursivitetit, mundëson narracionin. Përvijimi i këtyre atributiveve që ngërthen eseistika, ndërkohë është përcjellur:

Së pari: Në anën e kufirit të shtetit amë, pra në Shqipërinë londineze, proza dhe eseistika, janë parë si të ndërthurura, çka vihet re në trajtimet e kryera nga studiuesit dhe botuesit e veprës së tij, letrare dhe kulturore, ndonëse njihet, por pa ia përcaktuar ende vendin dhe rolin që bartin tekstet e realizuara si ese.

Së dyti: Në të përkundërt qëndrojnë studimet letrare të anës tjetër të kufirit, të Shqipërisë Atlantike, ku Sabri Hamiti, Kujtim M. Shala, e shohin esenë, tipin e shkrimit të gërshetuar të kërkimit me shprehësinë autoriale, që përcaktohet si një ese e mirëfilltë.

Së treti: Të një hipoteze, që do të kërkonte mund dhe kërkim, verifikim dhe interpretim, kontributin e jo pak studiuesve, se Konica ka realizuar ese të mirëfillta, ka hedhur themelet e saj, por vështrimi eseistik, i ndryshëm dhe i përkundërt, ndërkaq mbizotëron krijimtarinë letrare dhe kulturore, në prozë, publicistikë, përkthim, madje në vetë jetën prej bohemi të shkrimtarit. Hedhja e vështrimit, sado përkritazi, mbi veprat letrare Një ambasadë e Zulluve në Paris, Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit, ku ndërthuret artistikja me eseistiken, në një situatë të jashtëzakonshme, të krijon bindjen se vështrimin eseistik autori e shtriu edhe në veprën letrare. Po ashtu, teksti Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore, përveç të dhënave për historinë, gjuhën, origjinën e shqiptarëve, paraqet gjithçka me anë të një gjuhë të zgjedhur që e afron parashtrimin historiografik me natyrën e esesë. Leximi, analiza dhe interpretimi i teksteve të konceptuara si ese, po kaq interpretimi i interpretimeve të bëra nga studimet letrare, vetëm sa na ndihmon për të shkuar tek Konica, ku fle dija, arti, logjika, mençuria dhe mjeshhtëria e shkrimit.

Një nga pikat e lëna në terr, janë rrënjët e natyrës poliedrike, të personalitetit të papërsëritshëm, të cilat duhet të hetohen. Sendërtimi i eseistikës, i mendimit të lirë dhe argumentues, është prurja më e vlerë e Konicës. Adërmendësh, qëmtimi i vlerës së teksteve të esesë, duke qenë në fillësë, sepse brenda

shekullit të njëzet përjetoi shkëlqimin, rënien dhe rikthimin në panteonin e kulturës, do të kërkonte kohë dhe kontribute. Ky ishte një fat, i mbrapshtë dhe lodëtar, që u ra për hise mjeshtrave të fjalës shqipe, si At Fishta, Zef Skiroi, Ernest Koliqi, e dhjetëra figurave të tjera. Shumëplanësia e figurës dhe veprës, e materies eseistike, duhet parë në dyzimin e beftë, të plotënisë së jetës, me gjasë me paplotësinë e veprës. Një pjesë e teksteve mbetën të papërfunduara, çka është brenda rregullit, për të qenë ndryshe nga koha e tij. Individit, pavarësisht se diu të jetë njeri i lirë, shkrimtar jashtë kodeve, dashnor i zjartë dhe pa skrupuj, njëherit burrështetash i përkorë, fitoi mbi gjithçka, sidomos triumfoi mbi turmën, në gjallje dhe në amshim. Konica mbeti rebeli i pandreqshëm, që pati raste që nuk binte dakord as me veten. Paplotënia e veprës letrare, varësisht përcaktimit metaforik dhe simbolik, diku paraqitet e kryer, e diku e lënë në gjysëm të udhës, në të dy rastet na vjen e përsosur, përveç shkaqeve të tjera, se nuk ka kush t'i lexoj librat... siç e pati formula dikur, duhet marrë me rezervë. Pikërisht, paplotënia e veprës, kinse lënia e papërfundur e disa teksteve, e ndërlihd me plotësinë e jetës. Thelbi ekzistencial të jetës dhe veprës, të materies shkrimore eseistike, e përfaqëson rebelimi/kundërvënia, eventualisht ndryshimi me realitetet shqiptare. Duke qenë vepra e tij thellësisht rebele/eksperimentale, ajo është e plotë, e përfunduar, pra e kryer, si një sprovë autentike e shkrimtarit. Paplotënia, lidhet me paragjykimin e zakonit, sidomos më kërkimin e akademizmit allashqiptarçe në mungesat, si dhe me lëniën jashtë vëmendjes të pranisë së kësaj dukurie, letrare dhe kulturore. Duke i bartur të dy atributet, pra të mjeshtrit të fjalës, të magjistarit të fjalës përlindëse të gjuhës shqipe, Konica shënon një dukuri unike në kulturën shqiptare. Gjatë leximit dhe rileximit, ku “Natyrisht shumimi i librave lirik dhe i esesë mund të krijojë këtë e kam vënë re, një shenjë të prapë të leximit rreth veprave artistike në vend se të lexohen ato, kështu mund të pajisemi me opinionen në vend se ta edukojmë shijen.” (1980: 36), sugerim i T. S. Elioti tek libri Ese të zgjedhura, një fat i hidhur që i ra për hise edhe Konicës.

Në historinë moderne, për natyrën unike, Konica mbetet figura më befasuese e botës sonë, e prandaj zbulimi i këtyre rrënjëve, është shenjë e zgjerimit të komunikimit me natyrën, karakterin dhe laryshinë e veprës kulturore dhe letrare. Mjedis dëshimive, që të shpien kah rrënjët e njeriut gjenial, arrijtjeve në lëm të letrave, të vijnë në mend këto rrethana:

– Pinjoll fisnikësh të një derë me emër në ndihmë të dheut dhe gjuhës shqipe.  
– Njeriut bohemi, që gjithçka e kërkon përtej mëhallës së vetë. Teksa gjezdiste Parisin, Londrën, Nju Jorkun, kryqendra të qytetërimit botëror, vetëm pasuronte sqimën e tij, shpesh i habiste me dije dhe zgjuarsi sallonet mondane.  
– Nga të paktët poliglott buzëhollë, që

fliste dhe shkruante në shtatë gjuhë.  
– Misionari i ndarjes me tradicionalen, të mbytur në krenari dalëbojëse.

Bashkëshkrimi, ku fle arti dhe mendimi, shija dhe lodrimi, pohimi dhe tallja, aspirata dhe ideali estetik, gjerësia e kontributeve, që vjen dhe shpaloset në dy forma:

I – Me anë të lavrimit të shkrimit letrar dhe joletrar, ndryshe nga bashkëkohësit, duke shpallur botërisht kredonë e lëvizjes, në ritmin e botës së qytetëruar. Thelbi i ndryshimit ka të bëjë me eksperimentin dhe përmbysjen, tipare të cilat i hasim në çdo tekst shkrimor, ku secili tekst letrar dhe joletrar, bart një tipar të bashkëshkrimit, si një aureolë eseistike, pra me bashkëlidhjen, e shkrimit letrar dhe joletrar, të përcjelljes së materies, përmes vështrimit eseistik, që e bën më të rrokshme natyrën eksperimentale të veprës së larmishme të Konicës.

II – Me themelimin e mendimit eseistik, krahas të gjitha prurjeve letrare, madje të realizimit të llojit të esesë, në atë nivel dhe formësim të njëmendtë, në të gjitha tipet dhe llojet, duke gdhendur portretin e mjeshtrit të fjalës. Sendërtimi tipik dhe i përveçëm i esesë të mirëfillta, që tashmë bëjnë jetë më vete, si tipologji specifike, që bart dhe përçon logjiken dhe formalen, letraren dhe joletraren, për të formësuar kështu një tip të përveçëm të komunikimit. Realizimi me bukuri dhe magji shkrimi, në atë situim etik dhe estetik, të përkujton Pol Gajer, teksa shprehet se “kënaqësia që marrim nga e bukura është një reagim thjesht ndaj formës së perceptueshme të një objekti, pavarësisht nga përmbajtja që mund të ketë ajo, çka në rastin e eseistikes së Konicës lidhet me të dy rrafshet, të thënies dhe ligjërimit shprehës.

Pjesë unike e mendimit eseistik, mbase një testament vetjak, me gjasë një emblemë e pashmangshme e verifikimit, të dijes dhe idealit, është teksti “Lutje për shkrimtarin” një smerald pëmdritës i gazetës së mirënjohur “Albania”. Aty, më qartë se gjithkund dhe se gjithëherët, zbulohet në një dritë të pazakontë fuqia, shpirti, fryma e Konicës, teksa shprehet: “Ati yne që je në qiell, jepna fuqinë të mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë! Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetem me paanësi, por dhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembimet e gjuhës dhe lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

## Literatura:

Konica, Faik: Konica, Faik: Faik Konica-Veptra – Naim Frashëri, Tiranë 1993.  
Konica, Faik: VEPRA 2, Botimet DUDAJ, Tiranë, 2001  
Eliot, S. Tomas: Ese të zgjedhura – Rilindja, Prishtinë 1982.  
Todorov, Tzvetan: Poetika e prozës – Panteon, Tiranë 2000.  
Hamiti, Sabri: Faik Konica: Jam unë, Onufri, Tiranë 1994.  
Shala, M. Kujtim: Elipsa, Buzuku,

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kosova mposhti Moldavinë, mbetet në Ligën C

“Dardanët” pas dhjetë ndeshjeve e kanë shijuar fitoren të mërkurën në ndeshjen ndaj Moldavisë në “Fadil Vokrri” me rezultat 1-0. Kosova me këtë fitore e siguron qëndrimin në Ligën C

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka mposhtur Moldavinë (1-0), në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Në këtë mënyrë “dardanët” kanë përfunduar në pozitën e tretë në Grupin 3 të Ligës C dhe evituar barazhin. Golin e vetëm të ndeshjes e realizoi Lirim Kastrati në minutën e 31-të, kurse në pesë minutat e fundit “dardanët” luajtën me një lojtar me pak, pasi Ibrahim Dresheviq u

përfundoi me karton të kuq. “Kjo fitore na u ka dashtë pas një viti shumë të vështirë dhe ndaj një kundërshtari direkt për të qëndruar në këtë grup. Kundërshtari nuk ka pas çka të humb dhe ka luftuar për ta fituar ndeshjen dhe për të siguruar pjesëmarrjen në grup, andaj u munduan në fund të rrezikojnë, por mirë u përmbajtëm. Patëm raste, mundësi. Kundërshtarin nuk e lejuam të krijojë asgjë, nuk shfrytëzuam rastet e pastaj na u vështirësuan gjërat sidomos pas kartonit të kuq”, ka thënë trajneri Muharrem Sahiti. “Shumë do e



ndihmoj në aspektin psikologjik, pasi dihet situata dhe Covid që na ka dëmtu dhe penalizuar më së shumti neve, uroj të kalon koha e pandemisë, të jemi komplet dhe vitin e ardhshëm të fillojmë më mirë. Kjo fitore i

dedikohet Bernardit selektorit dhe i urojmë shërim të shpejtë”, ka shtuar Sahiti. Kosova ka përfunduar me pesë pikë këtë cikël të Ligës së Kombeve. Grupin e ka fituar Sllovenia me 14 pikë, ndërsa Greqia i ka

mbledhur 12 pikë. Sllovenia luajti sonte pa gola në shtëpi me Greqinë. Moldavia ka përfunduar në vendin e fundit në grup me një pikë dhe do të luajë në barazh për të evituar rënien në Ligën D.

## Shqipëria mposhti Bjellorusinë, siguron kalimin në Ligën B



**TIRANË, 18 NËNTOR** - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll e ka mbyllur me një fitore 3-2 edicionin në Ligën e Kombeve, duke siguruar vendin e parë në grup. Ky sukses i kuqezinjve i garanton Kombëtares kalimin për në Ligën B për në edicionin e ardhshëm, si dhe 1.1 milion euro në arkat e FSHF-së. Ishte një ndeshje shumë pozitive e skuadrës së drejtuar nga Edy Reja që do të zhblokonte ndeshjen në minutën e 19-të me Cikalleshin, i cili do të realizonte me kokë. Shtatë minuta më pas Shqipëria shënoi edhe golin e dytë, sërish me Cikalleshin, që ekzekutoi një 11-metërsh të fituar nga Manaj. Në minutën e 35-të, Bjellorusia dha sinjale reagimi, teksa do të shënonte me Skavysht, duke përfunduar nga një

gabim i Ismajlit. Gjithsesi gëzimi i tyre do të zgjaste shumë pak. Në minutën e 44-të, pas një aksioni të gjatë, Rey Manaj ndjek mjaft mirë aksionin dhe më pas arrin ta dërgojë topin në trekëndëshin e portës. Në fraksionin e dytë, Shqipëria ul disi ritmin e lojës, ndërkohë që Gjimeshiti, Laçi dhe Gjasula janë më të spikaturit. Uzuni shpërdoroi një mundësi shumë të mirë shënimi, ndërkohë që bjellorusët shfrytëzuan më së miri një përgjumje të mbrojtjes sonë, duke rihapur ndeshjen në minutën e 80-të me Max Ebong. Tjetër gabim i Ismajlit, i cili në fakt në disa raste shfaqti pasiguri me lojën e tij. Pavarësisht këmbënguljes së bjellorusëve, rezultati nuk do të ndryshonte deri në fund.

## Ferizaj në krizë financiare, futbollistët ndërpresin stërvitjet

**FERIZAJ, 18 NËNTOR** - Skuadra e Ferizajt është duke kaluar nëpër një krizë të thellë financiare. Klubi në faqen zyrtare në “Facebook” ka njoftuar se futbollistët nuk janë paraqitur të mërkurën fare në stërvitje. “Futbollistët e

skuadrës tonë nuk janë paraqitur fare në seancën stërvitore, për shkak të mos pagesës ndaj tyre. Arsyeja kryesore që e bojkotit të futbollistëve, është gjendja shumë e rëndë financiare që po kalon klubi ynë që shumë kohë.

Vendimi për bojkot është marrë nga futbollistët, të cilët nuk kanë marrë pagat e tyre. Klubi ynë është në gjendje të rëndë financiare dhe organizative, shpresojmë që aksionarët e klubit të ‘zgjohen’ nga ‘gjumi’ dhe t’i dalin në mbështetje

financiare klubit tonë. Ky klub, ky qytet, këta tifozë nuk e meritojnë këtë gjendje, andaj shpresojmë që sa më shpejtë të bëhet një zgjidhje në të mirë të klubit. Deri atëherë, futbollistët janë në bojkot”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Ferizajt.



## Test anti-Covid për të gjithë tifozët që do të përcjellin ndeshjet e NBA-së

ORLANDO, 18 NËNTOR - NBA-ja i ka informuar të gjitha skuadrat për mënyrën se si do të nisë sezoni i ri 2020-2021, që këtë herë do të zhvillohet si zakonisht dhe jo me sistem

grumbullimi, siç u mbyll sezoni i fundit. NBA sqaron skuadrat se mund të lejohen tifozët të vijnë në stadium dhe numri i tyre do të jetë në varësi të kapacitetit të stadiumit (15-20

deri 50% të kapacitetit). Distanca e tyre nga fusha do të jetë të paktën 30 hapa larg. Tifozët që dëshirojnë të vijnë në palestër duhet të kenë kryer një test anti-Covid të paktën 48 orë

para ndeshjes. Jo vetëm kaq, por ata duhet të kryejnë një test të shpejtë ditën e ndeshjes. Natyrisht që fansat do të mbajnë maskë në palestër dhe do të ruajnë distancimin social.



# Gent Avdijaj, futbollisti i ri që premtion shumë

PEJË, 18 NËNTOR - Në mesin e shumë sportistëve që na bëjnë krenar me punën dhe talentin e tyre, s'ka dyshim se është edhe futbollisti i brezit rinor që premtion shumë, Gent Avdijaj nga Peja. 16-vjeçari aktualisht luan si sulmues në kategorinë U17 në Besë e Pejës. Ai në një intervistë për gazetën lokale të Pejës "Zarfi Info", ka deklaruar se me futboll ka filluar të merret nga mosha 6-vjeçare dhe se vështirësia e tij më e madhe ishte se nuk dinte se ku t'i merrte hapat e parë për një karrierë të suksesshme. "Me futboll kam filluar të merrem nga mosha 6-vjeçare. Mendoj që sfida dhe vështirësia e parë ishte se nuk e dija se në cilën shkollë të futbollit t'i filloja stërvitjet dhe t'i merrja hapat e parë për një karrierë të suksesshme. Por fatmirësisht, rrugëtimi im i mbarë ka filluar me KF Besën dhe si i tillë po vazhdon edhe sot e kësaj dite sepse gjithçka që kam dashur jam duke e arritur në këtë klub", ka thënë Gent Avdijaj. "Qysh herët në fëmijëri më ka pëlqyer futbollit. Nga mosha 4-vjeçare mund të them se vazhdimisht qëndroja para televizorit duke i përcjell me vëmendje të gjitha ndeshjet futbollistike dhe ëndërroja se një ditë edhe unë do të bëhesha një futbollist i famshëm sikur ata prapa ekranit televiziv", ka shtuar futbollisti Avdijaj. Ai, gjithashtu tregon se ëndrën e tij ka filluar ta bëjë realitet nga mosha 6-vjeçare, sepse siç tha ai, synimet e dikurshme të fëmijërisë çdo ditë e më shumë po i bëhen realitet, falë dëshirës, vullnetit dhe dashurisë për futbollin. "Kam pas fatin e madh që themelet e futbollit t'i hapë në KF Besa dhe ndërtimin e karrierës time si futbollist ta bëjë në këtë klub, i cili për vite me radhë ka nxjerrë futbollist tejet të suksesshëm", ka thënë Avdijaj. "Kam marrë pjesë në shumë ndeshje dhe në shumicën prej tyre kam shënuar gola dhe kam bërë shumë asistime për shokët e skuadrës. Përgjatë këtyre viteve kam shënuar një numër të madh golash, shifrat e të cilave nuk po më kujtohen për momentin, por mund të them se në këtë drejtim qëndroj



shumë mirë", shtoi ai. I pyetur se cili prej klubeve ka qenë kundërshtari i tij më i fortë dhe si e sheh perspektivën e një futbollisti në Kosovë, Avdijaj është përgjigjur se: "Çdo klub ka kapacitetin e tij dhe nuk mund të thuhet se njeri klub është më i dobët ose më i fortë se tjetri, për arsye se gjithsecili lojtar e jep maksimumin e tij për të arritur një fitore. Pa marrë parasysh se në cilin vend ndodhesh, njeriu duhet të punojë shumë dhe të ketë dashuri për punën që bënë, ta japë maksimumin nga vetja dhe padyshim që do të ketë sukses në çdo vend, pse jo edhe në Kosovë". "Gjithçka që kam arritur deri më sot mirënjohës i jam familjes sime - në veçanti gjyshit, Dervish Avdijaj, të cilin e përshëndes shumë. Gjithashtu, dua ta falënderoj dajën Dritro Krasniqin edhe tezen time Laodikën të cilët ndodhen në Amerikë dhe më ndihmojnë për çdo gjë që më

nevojitet. Me këtë rast dua ta falënderoj edhe shokun tim Valdrin Krasniqi i cili është personi që kur isha fëmijë më këshillonte që të merrem me futboll dhe që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, vazhdon të më qëndroj pranë duke më ndihmuar dhe këshilluar për çdo gjë", tha futbollisti Gent Avdijaj. Avdijaj, gjithashtu bëri të ditur se që kur është bërë i njohur për angazhimin e tij në futboll, vazhdimisht merr lëvdata dhe komente të ndryshme nga bashkëmoshatarët dhe rrethi i tij i ngushtë. "Komentet që i marr nga bashkëmoshatarët e mi janë të shumta dhe gjithsecili prej tyre mund të them se më japin kurajo për të vazhduar përpara dhe mos të ngopem kurrë nga suksesi aktual", ka thënë Avdijaj, i cili shton se viti më i suksesshëm në karrierën e tij është viti 2019 ku ka fituar 2 kupa me ekipin e Besës dhe 1 me Reprerentacion në Mal të Zi.

### SHKURT

#### Gjermania ende beson te Lowi

Përzgjedhësi i Gjermanisë, Joachim Low nuk është në rrezik që të shkarkohet edhe përkundër humbjes së thellë nga Spanja (6-0). Oliver Bierhoff, drejtor i kombëtares, ka reaguar shpejt duke thënë se 60-vjeçari do të mbetet pjesë e kombëtares gjermane. "Sigurisht që po. Kjo lojë s'ndryshon asgjë. Do të vazhdojmë t'i besojmë Joachim Lowit, s'ka dyshim këtu", ka thënë ai kur është pyetur nga ARD nëse Lowi do të jetë trajner i Gjermanisë edhe në "Euro 2020", por që do të luhet më 2021. "Kur bëhet fjalë për përzgjedhësin e kombëtares, duhet të mendosh dhe analizosh nga kampionati në kampionat. Duam të arrijmë maksimumin në Evropianin e ardhshëm", ka shtuar Bierhoff.

#### Dzeko ende me Covid-19

Sulmuesi i AS Roma, Edin Dzeko ka kryer tamponin e radhës dhe ka mësuar se është ende i infektuar me Covid-19, çka rrezikon ta lërë jashtë edhe në sfidën e radhës kundër Parma. ANSA raporton se sulmuesi ka ngarkesë të ulët virale, por është ende pozitiv. Te Roma i infektuar me Covid-19 është edhe mbrojtësi i kombëtares shqiptar, Marash Kumbulla.

#### Kolasinaqi infektohet me Covid-19

Mbrojtësi i Arsenalit, Sead Kolasinaq është bërë lojtari më i fundit i Gunners që rezultoi pozitiv për koronavirus. 27-vjeçari doli pozitiv për Covid-19 të mërkurën në mëngjes dhe tani do të humbasë ndeshjen e Ligës së Kombeve të Bosnjës kundër Italisë. Kolasinaq luajti 90 minuta të plota ndërsa vendi i tij pësoi humbje 3-1 ndaj Holandës të dielën. Arsenali tashmë është pa Mohamed Elneny për udhëtimin e së dielës në Leeds pasi egjiptiani rezultoi pozitiv pasi shoku i ekipit ndërkombëtar Mo Salah gjithashtu u infektua.

#### City nuk heq dorë nga transferimi i Messit

Manchester City humbën shansin për transferimin e Leo Messit gjatë verës, por do të tentojnë transferimin e tij në janar. Marrëdhëniet mes argjentinasit dhe klubit spanjoll vijojnë të mos jenë në nivelin më të mirë të mundshëm, kurse Pep Guardiola është shumë i interesuar për ta pasur sërish në skuadër, ndaj dhe nuk përjashtohet mundësia që të ndodhë që në janar. Një tjetër fakt që e bën edhe më të mundshëm këtë lëvizje është edhe kontrata e argjentinasit që përfundon në fundin e sezonit, ndaj dhe mund të largohet me kosto zero. Humbja e një prej futbollistëve më të mirë në botë pa asnjë euro do të ishte një humbje katastrofike për katalanasit që po kalojnë një moment të vështirë pas pandemisë. Messi ka shënuar 640 gola në 741 ndeshje me skuadrën e Barcelonës.

## Koronavirusi shtyn ndeshjen Marsielle - Nice

Të paktën 10 nga 30 futbollistë që ka në organikë klubi francez i Nice, kanë rezultuar pozitivë ndaj koronavirusit dhe për këtë arsye

Komisioni i Garave në Ligue 1 ka vendosur shtyrjen e ndeshjes ndaj Marseille. Sfida ishte në plan për t'u zhvilluar këtë të shtunë,

por tashmë është shtyrë për në një tjetër datë, që pritet të vendoset në javët e ardhshme, pasi organizatorët e kampionatit

nuk dëshirojnë të rrezikojnë me përhapjen e koronavirusit. Kujtojmë që gjatë këtij fillim-sezoni ka pasur disa ndeshjet të

kampionatit francez që janë shtyrë për shkak të koronavirusit dhe janë shfrytëzuar mesjavat për rikuperimin e tyre.

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhësi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË  
(1990-1991)




“A po shkruan Barney?”  
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.  
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”  
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.  
 “A po të shiten librat?”  
 “Po marrë çeçe nga të drejtat e autorit”.  
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”  
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.  
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”  
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.  
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”  
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”  
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”  
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.  
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”  
 “Për femrat moderne”.  
 “Për femrat moderne?!”  
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrësisht të këqija”.  
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”  
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkitën dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €



Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI  
EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj







Në bazë të dispozitave të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), Vendimit të Kuvendit të Komunës për emërimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale KRM "UNITETI" Sh. A. Mitrovicë, komisioni komunal i aksionarëve në mbledhjen e mbajtur me 18.11.2020, mori vendimin për shpalljen e:

## KONKURSI

**Për zgjedhjen e 2 anëtarëve në Bordin e Drejtorëve të KRM "UNITETI" Sh. A. Mitrovicë**

**MANDATI:** i drejtorit të zgjedhur nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve është tre (3) vjet.  
**KOMPENSIMI I DREJTORËVE** do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike.

**KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE:** Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e drejtorëve duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
- të ketë përgatitje superiore;
- duhet ose (1) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune; apo (2) të jetë kontabilist i certifikuar, jurist i diplomuar, ose anëtar i certifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së (financa publike, prokurim, etj.)

## KUSHTET

Kandidati ka të drejtë të zgjidhet në Bordin e KRM "UNITETI", nëse:

- nuk ka qenë i dënur dhe nuk është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- nuk ka shkelur kodin etik, apo standardet e sjellës profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- nuk ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.

Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e KRM "UNITETI" nëse:

- ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse, ose cilës do nga filialet e saja brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- aktualisht ka, ose gjatë tri (3) viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të ndërmarrjes publike) me ndërmarrjen publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë;
- është aksionar, drejtor ose zyrtarë, në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
- pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse, ose nga cilado filialë e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ose është anëtar në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse, ose të cilësdo nga filialet e saja;
- ka shërbyer në Bordin e drejtorëve të ndërmarrjes publike përkatëse, më shumë se nëntë (9) vite nga dita e parë e zgjedhjes së tij;
- është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurren me ndërmarrjen, ose është një menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar ( i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit), ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë në ndërmarrjen;
- është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit, ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik, ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës, në një parti politike,
- ka çfarëdo konflikt të interesave që, për nga natyra, do të shkaktojnë që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.
- nëse punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje publike përkatëse ku kandidati punon.

## INFORMATË PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT

Kandidatët për drejtor në Bordin e drejtorëve të KRM "UNITETI" Mitrovicë, duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- CV-në,
- Letër motivimi,
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit),
- Dëshminë mbi përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime.

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilin deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit; pavarësinë dhe përgatitjen profesionale. Çdo përgënjeshtim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm.

Konkursi zgjatja 15 ditë nga data e shpalljes: 19.11.2020 deri me dt. 03.12.2020

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në objektin e Komunës të Mitrovicës së Jugut. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Ylli B Reisen" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70192337

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 3-111-56893  
Datë: 18-11-2020



KOMUNA LIPJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyratë Publik nr. 06/L-114, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

## KONKURS

### Për plotësimin e vendeve të punës

Pesë (5) Mjek të Përgjithshëm në QKMF-Lipjan.

Një (1) Specialist i Peditrisë në QKMF-Lipjan.

Një (1) Laborant i Biokimisë në QKMF-Lipjan.

### Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek të Përgjithshëm:

- Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen duke respektuar kodin e mirësjelljes.
- Bën diagnozën initiale dhe trajtimin e sëmundjes.
- I përgjigjet nevojave të QKMF-së dhe punkteve të tjera në KPSII.
- Referon tek specialisti, nëse është e domosdoshme.
- Kryen shërbime të shëndetit reprodaktiv, kujdesit antenatal dhe postnatal.
- Shërbime shëndetësore për fëmijë.
- Promovon edukimin shëndetësor në shoqëri.
- Trajton lëndimet e vogla.
- Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme.
- Gjatë punës së tij i asistojnë infermierët.
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i Kujdesit Primar Shëndetësor nëpër punkte të tjera shëndetësore në Lipjan, me kërkesën e menaxherit dhe Drejtorit të QKMF-së.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet stafit menaxhues të QKMF-së dhe DSHPS-së.

### Detyrat dhe përgjegjësitë për Peditër:

- Udhëheq dhe organizon punën në njësinë konsultative –pediatrike në QKMF.
- Mban përgjegjësi për kontrollimin, hulumtimin, diagnostikimin, trajtimin (përcjellje të vazhdueshme të pacientit, po ashtu është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacion dhe në evidencë shëndetësore gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore që përmbajnë të dhëna për identitetin personal të banorit, diagnozën dhe trajtimin dhe udhëzon infermieret për trajtim.
- I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente.
- Bën kontrollime specialitike - pediatrike të pacientëve me udhëzim të mjekut.
- Merr pjesë në mbledhjet të cilat i fiton shefi i mjekësisë familjare ose Drejtori e në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative.
- Pediatri duhet të merr pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional të organizuar në QTMF dhe bën vlerësim për të specifikuar nevojat për trajnimin dhe zhvillimin profesional përmes koordinorit të QTMF-se ose Drejtorit të QKMF-se në trajnimet e organizuara nga QZHM – MSH.
- Është përgjegjës për të zbatuar detyrat sipas ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore të institucionit shëndetësor që janë Statuti i QKMF-se, aktvendimet, urdhëresat tjera lëshuar nga DSHPS-se.
- Kryen edhe punë tjera në kuadër të profesionit – fushë veprimtaria e tij me kërkesë të Drejtorit të QKMF-së.
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të mjekëve, Drejtorit të QKMF-se dhe Drejtorit të DSHPS-së

### Detyrat dhe përgjegjësitë për Laborant:

- Kryen punët rreth marrjes së mostrave hematologjike prej pacientëve
- Kryen punët rreth regjistrimit, klasifikimit dhe shpërndarjes së rezultateve laboratorike.
- Kryen edhe punët tjera në lëminë laboratorike sipas urdhërave të shefit të njësisë edhe nëpër punkte tjera nëse paraqitet nevoja.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet shefit të njësisë si dhe Drejtorit të QKMF-së

### Kushtet dhe kriteret për Mjek të Përgjithshëm:

- Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm.
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi kopje.

### Kushtet dhe kriteret për Peditër:

- Fakulteti i Mjekësisë - Specialist i Peditrisë
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore.
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan.
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime.
- Letërnjoftimi kopje.

### Kushtet dhe kriteret për Laborant i biokimisë:

- Përgatitja e lart profesionale Bachelor– Laborant i/e biokimisë
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore.
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan.
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime.
- Letërnjoftimi kopje.

### Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkuara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.

### Paga mujore për Mjek të Përgjithshëm:

Koeficienti: 7.2  
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar  
Puna Provuese gjashtë muaj (6)

### Paga mujore për Peditrin:

Koeficienti: 8.4  
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar  
Puna Provuese gjashtë muaj (6)

### Paga mujore për Laborant:

Koeficienti: 5.4  
Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar  
Puna Provuese gjashtë muaj (6)

### Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, web faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.


### Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit, sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

### Vërejtje:

Dokumentet e pranuar duhen të janë kopje të noterizuara dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtoresha e DSHPS-së  
Dr. Merita H. BYTYQI





REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Br: 3-111-56893  
Datum: 18-11-2020



KOMUNA LIPJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

#### DIREKTORAT ZA ZDRAVSTVO I SOCIJALNE BLAGOSTANJE

Na osnovu člana 67 i 68 Zakona za Javni Službenici br. 06/L-114, član 8 Zakona Rada br. 03/L-121, Administrativni Uputstvo Br.07/2017 za određivanje procedure konkursa u javni sektor, član 49 tačka 49.2 Statuta Opštine Lipjan, Direktorica za Zdravstvo i Socijalnu Blagostanje obavlja:

### KONKURS

#### Za dopunu radnih mesta

Pet (5) Lekara Opšte prakse u GCPM-Lipljan.

Jedan (1) Specijalista Pediatrije u GCPM-Lipljan.

Jeda (1) Laborant Biohemije GCPM-Lipljan.

#### Zadaci i Odgovornosti za Lekara Opšte prakse :

1. Pruža primarnu zdravstvenu zaštitu pacijentu i porodici poštujući kod ponašanja.
2. Obavlja inicijalnu dijagnozu i tretiranje bolesti.
3. Potrebama odgovara GCPM -a i ostali punkta u PZZ.
4. Upućuje kod specijalista, ako je neophodno.
5. Obavlja usluge reproduktivnog zdravlja, antenatalne i postnatalne zaštite.
6. Zdravstvene usluge za decu.
7. Promoviše zdravstveno obrazovanje u društva.
8. Tretira lakše povrede.
9. Obavlja kućne posete kada je to neophodno.
10. Tokom svog rada, asistira ufermieri.
11. Obavlja i ostale poslove iz oblasti primarnog zdravlja u drugim zdravstvenim punktovima u Lipjanu, sa zahtevom menadžera i direktora GCPM-a.
12. Za svoj rad odgovara rukovodiocem osoblja GCPM i DZSB.

#### Zadaci i Odgovornosti za Pediatrar:

1. Vodi i organizuje rad u pedijatrijskoj konsultativnoj jedinici u GCPM.
2. Snosi odgovornost za kontrolisanje, istraživanje, dijagnosticiranje, tretiranje, (stalno praćenje pacijenta) takođe je odgovoran za tačnost podataka evidentirano u dokumentaciji i zdravstvenim evidencijama tokom pružanja zdravstvene usluge koje sadrže informacije o ličnom identitetu stanovnika, dijagnozu i tretiranje i upućuje inferierima za tretiranje.
3. Ogovara emergentskim situacijama i vanrednom stanju u svako doba, i traži podršku u emergentskim situacijama.
4. Obavlja specijalističko -pedijatrijske preglede pacijenata prema uputstvima lekara.
5. Učestvuje na sastancima koje saziva šef porodične medicine ili direktor iu kojima se raspravlja o raznim profesionalnim temama ili organizacionim pitanjima.
6. Pedijatar treba da učestvovati u stalnim profesionalnom edukacije organizovane u GTPM-u i obavlja procenu oko potrebama za obuke profesionalni razvoj preko koordinatora GTPM-a ili direktora GCPM-a na obuke organizovane GRPM - MZ.
7. Odgovoran je za sprovođenje zadataka u skladu sa zakonima na snazi i podzakonskim aktima zdravstvene institucije kao što su statut GCPM, rešenje, i drugih upustva iz DZSB.
8. Obavlja i ostale poslove u okviru struke - svoje delatnosti sa zahtevom direktora GCPM-e.
9. Za svoj rad odgovora glavnom šefu lekara, direktoru GCPM-e i direktoru DZSB-a

#### Zadaci i odgovornosti za Laborant Biohemije:

1. Obavlja rad oko hematološke mostre od pacijenata
2. Obavlja poslove oko registracije, klasifikacije i podele laboratorijskih rezultata.
3. Obavlja ostale poslove na laboratorijskom iz oblasti laboratorije prema upustvu šefa jedinice i u ostalih punktovima ako je potrebno.
4. Za svoj rad odgovora šefu jedinice kao i direktoru GCPM-e

#### Uslovi i Kriterijumi za Lekara Opšte Prakse:

- Medicinski Fakultet –Opšti smer.
- Radna Dozvola
- Zdravstveni Certifikat
- Certifikat da nije pod istragom iz osnovnog Suda Priština ogranak Lipljan
- Potvrdu iz policije da nije pod istragom
- Kopije Lična karta.

#### Uslovi i Kriterijumi za Pediatrar:

- Medicinski Fakultet - Specialist Pediatrije
- Ličenca Rada
- Zdravstvene Certifikat.
- Certifikat da nije pod istragom iz osnovnog Suda Priština ogranak Lipljan.
- Potvrdu iz Policije da nije pod istragom.
- Kopije Lične Karte.

#### Uslovi i Kriterijumi za Laborant Biohemije:

- Visoka stručna sprema Bachelor– Laborant biohemije.
- Ličencu Rada
- Certifikat Zdravstva.
- Certifikat da nije pod istragom nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan.
- Potvrda iz Policije da nije pod istragom.
- Kopija Lične Karte.

#### Sposobnost:

- Komunikacije sposobnosti
- Sposobnost da vode samostalni rad poštujući Zakon i etiku
- Sposobnosti u organizaciji rada i obavljanje zadatke gore navedene
- Veštine i personalne kvalitete.

#### Mesečna plata za Opšti Lekara:

Koeficienti: 7.2  
Rok trajanja ugovora neodređeno vreme  
Probni Rad šest meseci (6)

#### Mesečna plata za Pediatrar:

Koeficienti: 8.4  
Rok trajanja ugovora neodređeno vreme  
Probni Rad šest meseci (6)

#### Mesečna plata za Laborant:

Koeficienti: 5.4  
Rok trajanja ugovora neodređeno vreme  
Probni Rad šest meseci (6)

#### Rok i način prijave:

Konkurs je otvoren 15 nakon objavljivanja u medijima, na web stranici Opštine kao i na oglasnoj tabeli.

#### Podnošenje zahteva:

Prijave se mogu dobiti u kancelariji za usluge građanima u opštini Lipljan, šalter br. 3 i podnose se na istom šalteru zajedno sa dokumentima traženim na konkursu.

#### Primedba:

Primljeni dokumenti moraju biti overene kopije i ne vraćaju, ali nekompletirane i nakon roka ne razmatraju.



Direktorica DZSB-a  
Dr. Merita H. BYTYQI



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

